

INTERVISTË ME ELIZABETH GOWING

Prishtinë | Data: 19 nëntor, 2017 dhe 23 shkurt, 2018

Kohëzgjatja: 85 minuta

Të pranishëm:

- Elizabeth Gowing (E intervistuar)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Elizabeth Gowing: Quhem Elizabeth Gowing dhe jam lindur në Britani në një qytezë të quajtur Ely e cila gjendet në Cambridgeshire në lindje të Anglisë. Ishim aty për shkak të punës së babait. Ai punonte në Forcën Ajrore, kështu që, gjithë fëmijërinë time kemi lëvizur nga një vend në tjetrin. Pra, nuk kemi qëndruar gjatë në asnjë... dhe në fakt, edhe babai i tij kishte punuar në Forcën Ajrore. Babai i nënës time kishte punuar në Forcën Ajrore poashtu për një kohë të shkurtër. Kështu që është shumë e vështirë kur njerëzit në Kosovë më pyesin se nga vij, sepse në fakt nuk vij nga asnjë vend. Nuk kam, as nga babai e as nga gjyshi nuk kam një vend i cili është, e dini, i yni.

Pra, po mendoj, unë jam e lumtur për këtë gjë, mirëpo e komplikon bisedën. Kemi jetuar në Ely për... më duket se kam qenë një vjeç kur jemi zhvendosur nga atje dhe jemi kthyer në Cambridgeshire disa herë të tjera përgjatë fëmijërse time. Por nuk ndihem sikur jam nga Cambridgeshire, thjesht ka ndodhur që jam lindur aty.

Erëmirë Krasniqi: Si e kujtoni fëmijërinë tuaj, në lëvizje, në lëvizje të përhershme?

Elizabeth Gowing: Po, nuk më është dukur si lëvizje e përhershme. Më është dukur më shumë si... mendoj se nëna ime është shumë e mirë... ajo është shumë e adaptueshme dhe e aftë të krijojë ndjenjën e shtëpisë dhe sigurisë, e dini, prandaj kjo nuk më është dukur si mënyrë e vështirë e të jetuarit. Në fakt mendoj se kjo gjë më ndihmon me jetën time të çuditshme tani. Sepse tani jetoj në tri vende, kam tri shtëpi. Dhe unë, mesatarisht në muaj kaloj dy-tri fundjava në Kosovë, pra jam këtu për rreth nëntë ditë në muaj. Dhe pastaj qëndroj në Shqipëri pjesën tjetër të kohës, përveç një jave të cilën e kaloj në Angli. Kështu që, përafërsisht ky është muaji im, i ndarë në tri pjesë.

Kështu që ndoshta ideja e të qenit gjithmonë në lëvizje, apo krijimi i ndjenjës së shtëpisë kudo që je e cila ndoshta ka ardhur nga fakti se kemi lëvizur shumë si fëmijë... Dhe unë kam qenë... jemi dy fëmijë, unë dhe motra ime, por unë jam lindur e para dhe isha pesë vjeç kur u lind motra ime. Kështu që praktikisht unë isha fëmijë i vetëm për një pjesë të madhe të fëmijërisë time.

Pastaj kur u bëra nëntë vjeç më dërguan në një shkollë me konvikt meqë babai im ishte në Forcën Ajrore, dhe për shkak të lëvizjeve të përhershme. Pra, është normale për fëmijët, prindërit e të cilëve janë në forcë ajrore, të shkojnë në shkolla me konvikte. Kjo ishte në rregull, nuk më pëlqente të shkoja në atë lloj shkolle por mendoj se ishte... më ka dhënë shumë mundësi e dini, ishte shkollë shumë e mirë. Dhe më ka dhënë shumë mundësi akademike por edhe sociale, për shembull Forca Ajrore e jep një kontribut për shkollim. Gjithashtu kam fituar bursë për shkollim.

Dhe familja ime ishte një nga familjet më të varfëra në shkollë. Po mendoj, nuk ishim të varfër por krahasuar me të tjerët, ata ishin tepër, tepër të pasur, njëfarë lloj, fëmijë elitë, vajza elitare. Ishte një shkollë vajzash. Dhe kështu që mendoj se kjo më ka dhënë... në fillim më është dukur e vështirë sepse ato të gjitha kishin rroba të bukura dhe gjërat materiale kishin shumë rëndësi aty. Kjo ishte Britania e viteve të 1980-ta, në kohën e Margaret Thatcher. Dhe kështu ideja e të pasurit etiketat e duhura në rroba kishte shumë rëndësi.

Kjo gjë ishte shokuese për mua sepse familja ime nuk është e tillë, por mendoj se kam mësuar nga kjo, thjesht, për të mos i dhënë rëndësi kësaj. Dhe mendoj se më ka dhënë vetëbesim kur u mësova me të. Më ka dhënë vetëbesim për të mos dëshiruar të jem si njerëzit e pasur apo tepër të privilegjuar dhe për të mos u ndjerë... të kem vetëbesim për të thënë, “Kjo nuk është bota ime dhe nuk do të garoj me ju, nuk kam nevojë të kem etiketat e duhura në rrobat e mia. Ka gjëra të tjera më të rëndësishme”.

Jam mirënjohëse për atë përvijë sepse, po mendoj, përndryshe do të mund ta kisha kaluar gjithë jetën duke menduar se ka njerëz të pasur apo elita të cilat... apo se ekziston një botë pjesë e të cilës nuk mund të jem. Dhe tashmë disi e kam parë atë botë dhe jam rehat duke e injoruar (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Ku ishte kjo?

Elizabeth Gowing: Shkolla ishte në Malden, që i bie në qendër të Anglisë. Është një qytezë tepër e bukur, por shumë e çuditshme. Në shekullin XIX ishte tepër e famshme për ujin. Uji i atjeshëm supozohej të ishte shumë i mirë për shëndet. Ishte si një qytet-banjë. Njerëzit vinin në qytetin-banjë për të marrë ujë për shëndetin e tyre.

Kështu që kishte shumë shtëpi të mëdha të ndërtuara atje. Shtëpi viktoriane. Ishin tepër të mëdha për një familje normale, prandaj shumë prej tyre janë shndërruar në shtëpi për të moshuar apo shkolla me konvikte. Kështu që kur isha atje, ishin pesë shkolla me konvikte dhe vetëm një shkollë shtetërore. Dhe katër prej pesë shkollave me konvikte, ishin shkolla vajzash dhe një prej tyre ishte shkollë djemsh. Është një mënyrë e çuditshme për t'u rritur (qeshë). Nuk është normale, saktësisht, nuk është një demografi normale. Ose shumë njerëz të moshuar të cilët ishin tepër të pasur, dhe katër herë më shumë vajza sesa djem. Pra, kisha një adoleshencë të çuditshme (qeshë)...

Erëmirë Krasniqi: Si ndodhte ky komunikim ndër-gjenerata?

Elizabeth Gowing: Në fakt nuk ishte me të vërtetë komunikim ndër-gjenerata. Do të doja të kishte qenë, por shkollat tjera, ndoshta tani janë ndryshe, por shkollat ishin shumë të tërhequra. Dhe nuk inkurajonin lidhje me shkollat tjera apo me komunitetin vendas apo... mendoj se shqetësimi i tyre ishte për të na mbajtur të sigurt. Por mendoj se kemi humbur mundësi për... sepse për shembull unë kam shkuar për të parë shtëpitë e të moshuarve.

Më kujtohet, kishim disa programe vullnetarizmi ku shkonim... gatuanim drekë dhe pastaj ftonim disa nga të moshuarit për të ngrënë drekë. Më kujtohet që e kemi bërë këtë gjë disa herë. Dhe pastaj kur isha në klasën e gjashtë, pra, në pjesën e mesme të shkollës, unë... Kishte një nismë të madhe vullnetare dhe kam kaluar kohë në një strehimore për gra të cilat i kishin mbijetuar dhunës në familje. Dhe kjo ishte, më është dukur si një lidhje me jetën dhe komunitetin e vërtetë. Kështu që, jam e lumtur

që shkolla jonë pati ofruar atë mundësi. Mendoj se është një mundësi që në Kosovë është ende shumë e rrallë, për njerëzit, për studentët të inkurajohen të krijojnë lidhje të tilla.

Kështu që, kur e kam arritur atë moshë, sa më shumë jam rritur, në vitet e fundit të shkollës, kam pasur mundësi të jem më shumë personi që kam dashur të jem. Kam filluar në grupin e Amnesty International në shkollë dhe isha përfaqësuese për vullnetarizëm dhe.... Kjo është koha kur kam filluar të bëj disa nga gjërat të cilat vazhdoj t'i bëj. Pra...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë lloj edukimi ishte ky? A ishte më shumë si arte liberale apo?

Elizabeth Gowing: Ishte goxha shkollë akademike, kështu që supozoj se ishte goxha e vështirë, dhe goxha rigoroze në aspektin e të mësuarit akademik. Por kishte gjithashtu shumë mundësi për teatër... E dini, kam luajtur në shfaqje dhe kam ushtruar të folurit në publik, gjë të cilën e bëj shpesh sot. Jam e lumtur që kam marrë trajnim për të folurit në publik. Madje edhe gjëra të tjera si lojë me shpata, e dini, loja me shpata {shpjegon me gjeste}, nuk di si ta them në shqip. Jo shumë shkolla kanë ofruar mësim për dyluftime me shpata. Kisha një gjysëmvetor përgjatë të cilit mësova golf. E dini, shumë mundësi të cilat nuk do të të ofroheshin në një shkollë normale shtetërore. Prandaj mendoj se kjo është ajo që vjen me faktin e të shkuarit në një shkollë të privilegjuar. Kam pasur shumë mundësi.

Erëmirë Krasniqi: Cila ishte lidhja jote me familjen përgjatë kësaj kohe? Po mendoj, si ke komunikuar me ta?

Elizabeth Gowing: Mendoj se ka qenë, mendoj se kemi qëndruar shumë afër. Njerëzit mund të mendojnë se kjo është diçka e çuditshme, po mendoj, edhe në Angli është tepër e çuditshme, dhe me siguri edhe në Kosovë, ideja e të mos qenit me familjen. E di se prindërit e mi e kanë marrë si diçka shumë të vështirë. Ata nuk dëshironin të më kishin larg. Por shkruanim shumë letra, kjo ishte përpara gjithë formave të tjera të komunikimit dhe kam shkuar për vizitë ndoshta çdo të tretën javë ose çdo muaj. Duket e çuditshme të flas për këtë gjë tani, natyrisht kur kam shkuar në shtëpi për festa ka qenë kohë tepër e veçantë. Ishte, sepse ishte thjesht kohë e lirë dhe kualitative dhe kurrë nuk grindesha me prindërit për detyrat e shtëpisë apo për ndarjen e banjos, e keni parasysh, rutina e një jete normale familjare. Por kur isha në shtëpi, ishte disi si qerasje për të gjithë. Kështu që, rritja ka qenë periudhë e lumtur.

Erëmirë Krasniqi: A lëviznin ata përbrenda Anglisë apo edhe nëpër botë?

Elizabeth Gowing: Po, edhe nëpër... kanë jetuar në Belgjikë, kemi jetuar edhe në Gjermani kur kam qenë më e vogël, para se të shkoja në shkollë, por Belgjika dhe Algjeria, këto ishin dy shtetet e huaja gjatë kohës së shkollimit tim. Pastaj ata kanë jetuar edhe në Londër për ca kohë. Kështu që po, kam pasur rastin ta eksploroj edhe botën përgjatë pushimeve.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ka ndodhur tutje në jetën tuaj, pas shkollës?

Elizabeth Gowing: Aplikova në Universitetin e Oksfordit dhe u pranova, por gjithashtu bëra një vit pauzë brenda të cilit udhëtova shumë. Kam shkuar në Indi, Egjipt dhe Afrikë Veriore. Kam bërë shumë punë vullnetare, kam punuar me të pastrehë dhe kam bërë shumë punë të tjera me pagesë, kam

punuar si sekretarëshë, si pastruese, kam punuar në një restaurant në mënyrë që të kursej para për të udhëtuar. Ishte vit i mirë e dini, duke provuar gjëra, duke u bërë person i rritur.

Erëmirë Krasniqi: A mund të na përshkruani një prej vendeve ku e keni gjetur vetën më shumë si në shtëpi, apo jeni përshtatur më shumë...

Elizabeth Gowing: Po, kjo është pyetje e mirë...

Erëmirë Krasniqi: Sepse është e vështirë kur lëvizë nga një kampus në një tjetër.

Elizabeth Gowing: Po, po supozoj se koha e punës vullnetare për një organizatë bamirësie për të pastrehët. Kam shkuar dhe u kam dhënë ushqim njerëzve që flinin në rrugë, dhe kam biseduar me ta rreth... Shpesh ata kanë mbijetuar duke mbledhur mbeturina... duke mbledhur ushqim në kontejnerë. Kjo ka qenë në Londër. Pra kam jetuar në Londër për ndoshta katër vjet dhe kam menduar se e kam njohur qytetin. Por kjo ishte një pamje tejte e qytetit që më ka bërë ta kuptoj realitetin, një qytet gjithmonë e ka një ndër-kërthizën, njerëzish të cilët, ku ndodhin keqpërdorimet me drogën apo ku ka probleme me shëndetin mendor apo arsye pse ata nuk janë me familjet e tyre apo në shtëpi, por... pastaj sa fragjilë janë. Kështu që besoj se mund të bësh një lidhje midis asaj dhe pastaj kësaj që e gjej veten duke e bërë në, në Kosovë.

Erëmirë Kasniqi: Si ishte Anglia në atë kohë, përmendët Thatcher e cila ishte e fuqizuar...

Elizabeth Gowing: Po, në fakt ajo humbi pushtetin atë vit kështu që, uhm, si ishte Anglia? Epo, mendoj se Anglia nuk ishte vend i mirë përgjatë Britanisë së Thatcherit. Duke qenë se isha rritur në një shkollë private, ndoshta nuk isha e hapur dhe nuk isha e lidhur me gjithë vendin tim.

E dini grevën e minatorëve për shembull e cila është një ngjarje e madhe në historinë dhe identitetin e Britanisë së sotme. Ajo ka ndodhur gjatë kohës kur unë kam qenë në atë shkollë dhe unë mezi e kam vërejtur se ka ndodhur, e dini, thjesht kjo gjë dukej si tepër larg, nuk e prekte botën time të privilegjit. Ndihem e turpëruar për atë gjë tani sepse po të kishte një grevë të minatorëve tani dhe mënyra se si ajo e ka ndarë vendin dhe... atëherë unë do të doja të isha e angazhuar dhe do të doja... nëse do të kisha një vajzë, do të doja që ajo të angazhohej. Por unë isha heshtur në këtë flluskë të shkollës private. Pra mendoj, ndoshta nuk e kam ditur si ishte Britania dhe prandaj viti im i pauzës ishte shumë i rëndësishëm, sepse pata rastin të kuptoj disa realitete.

Erëmirë Krasniqi: A i ke vizituar gjithë vendet që i përmende brenda atij viti të vetëm?

Elizabeth Gowing: Po, kam udhëtuar shumë. Në fillim kisha planifikuar të udhëtoj me autobus, me një grup, po mendoj, të udhëtoja me një grup nga Anglia poshtë në Evropë dhe pastaj nëpër Iran. Dhe oh, Afrikë Veriore pastaj në Iran dhe pastaj në Indi.

Pastaj e ndërrova mendjen dhe vendosa t'i bëj këto udhëtime vetëm, në vend se ta bëj më një grup njerëzish. Kështu që organizova shumë udhëtime të ndryshme. Gjë kjo e cila ishte e mirë sepse nënkuptonte se mund të punoja ngapak, të udhëtoja ngapak, të punoja ngapak, të udhëtoja ngapak, kështu që po...

Erëmirë Krasniqi: A ishte e zakonshme në atë kohë të shkoje në Indi si britaneze, po mendoj a ishin këto rrugë të trasuara tashmë me kolonializëm?

Elizabeth Gowing: Po. Kishte shumë njerëz, po. Saktësisht. Dhe ishte, është një vend ku flitet anglisht, shumë njerëz atje flasin anglisht, është vend i njohur në identitetin britanik sepse siç e the edhe ti, ishte njëra nga kolonitë tona. Kështu që, megjithatë pjesë e mbretërisë. Pra po, kishte shumë *backpackers* [avaturier] gjatë kohës sa isha atje. Por megjithatë ishte me të vërtetë përvojë e mrekullueshme. Dhe natyrisht, kur shkon nëpër vende për kohë të shkurtër nuk ke mundësi t'i kuptosh ose të futesh në lëkurën e tyre. Por udhëtimi vetëm ishte shumë gjallërues. Më kujtohet kur kam shkuar në Indi, në fillim doja të udhëtoja me një grup njerëzish por mbërriva atje një ditë më herët. Pra, mbërriva atje dhe kisha një ditë vetëm për veten në Delhi, isha 17 vjeç dhe (qeshë) është pak e frikshme kur e mendon dhe... a isha 17 vjeç? Po, 17.

Dhe nuk dija çfarë të bëja. Vetëm ecja nëpër qytet me sy hapur duke shikuar. Dhe u ula në një park e një djalë m'u afrua e më ofroi të m'i pastrojë veshët me disa mjete të metalit, diçka që dukej si lugë e madhe dhe një shkop i gjatë. Dhe më kujtohet vetja duke menduar, "Do ta provoj këtë gjë". Dhe tani mendoj për atë se si e lejova një djalë të cilin nuk e kisha takuar kurrë të futë një shkop të metalit në veshin tim dhe të m'i pastrojë veshët në publik (qeshë). Por kjo ishte një përvojë që nuk kishte ndodhur në shkollën time private në mes të Anglisë. Po, ishte ekzaltuese.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ke bërë më tutje, si lidhet kjo përvojë me tjetrën?

Elizabeth Gowing: Pra, pastaj kam shkuar në Oksford ku kam studiuar Letërsi Angleze. Oksfordi është vend i mrekullueshëm, Universiteti i Oksfordit është thjesht universitet me shumë mundësi, kështu që isha shumë me fat dhe shumë... Mendoj se kam pasur shumë mundësi, kam bërë shumë gjëra, jam përfshirë në shoqërinë ambientaliste, jam përfshirë si vullnetare në një organizatë humanitare që punonte me njerëz me AIDS. Kam punuar si mësuese, mësuese vullnetare për emigrantët që sapo kishin ardhur në Angli. Kështu që, kam bërë shumë punë vullnetare aty por gjithashtu shumë dramaturgj, kam bërë regjinë e një shfaqjeje. Kam pasur disa shfaqje, regjinë e të cilave e kam bërë unë dhe e dini, shumë biseda e ligjërata e... Jo vetëm për studimet e mia por për gjëra të ndryshme. Kam takuar njerëz të cilët ishin shumë të ndryshëm nga unë, kështu që shtë një vend shumë, shumë i pasur me përvoja.

Por ndoshta gjëja më e rëndësishme është se aty kam takuar Rob, i cili është partneri im. Jemi bashkë për 25 vjet. Atë e kam takuar në vitin e parë të studimeve dhe jemi bashkë që atëherë. Kështu që kjo është gjëja më e çmueshme që kam nga ajo kohë.

Erëmirë Krasniqi: A të është dukur si një fluskë tjetër, po mendoj në kuptimin w privilegjit... po pyetem...

Elizabeth Gowing: Nuk mendoj se më është dukur ashtu, mund të jetë, ndoshta më është dukur si fluskë sepse është vend i privilegjuar. Por mendoj isha më aktive me njerëz të cilët nuk ishin vetëm nga universiteti. Gjëra sikur puna me këtë familje e cila sapo kishte ardhur nga Afrika, si mësuese,

mësuese në shtëpi për fëmijët e tyre. Apo puna me njerëzit që kishin AIDS, apo e dini, ndihesha sikur po lidhesha me botën e cila nuk ishte vetëm botë e privilegjit.

Kështu që, mendoj se... dhe mendoj se kjo është një nga fuqitë e Oksfordit dhe universiteteve të tjera në Britani, është fakti se ata punojnë fort për të ofruar mundësi. Prandaj natyrisht njerëzit mund të shkojnë dhe të jetojnë në botën e elitës dhe kjo është ajo që disa njerëz duan nga Oksfordi. Por nëse bashkon mijëra njerëz inteligjentë, atëherë do të gjesh njerëz që gjithashtu duan të bëjnë diçka me idetë e tyre. Dhe mendoj se kjo ishte një nga mundësitë që më dha Oksfordi, pra të shoh se si bëjnë njerëzit diçka të tillë dhe çfarë mund të arrihet. Dhe mënyra si mendoja unë për botën ishte sfiduese.

Erëmirë Krasniqi: Si e ke takuar Rob në Oksford?

Elizabeth Gowing: Në një festë. Ai aktronte shumë në atë kohë dhe kishte qenë në një shfaqje. Ishte një festë e një mikut tonë dhe ai erdhi në fund të festës dhe po... filluam të bisedojmë dhe ai më përcolli në shtëpi e pastaj më puthi, shumë shpejt, kështu që po. Mendoj se do të ishim takuar eventualisht. Kishim shumë miq të përbashkët dhe kishim interesa të përbashkëta, e keni parasysh, nuk është një nga ato takimet e çuditshme ku mund të mendosh, *për pak* [flet shqip] e humbëm njëri-tjetrin. Por ishte e thënë që ne të bëheshim me njëri-tjetrin në shumë mënyra tjera praktike dhe domethënëse.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë ke qëndruar aty ose...

Elizabeth Gowing: Në Oksford? Për tri vjet. Pastaj kam vendosur se doja të bëhesha mësuese. Dhe m'u desh të bëj një vit tjetër trajnim për mësuese dhe m'u desh të bëja më shumë para, dëshiroja ta financoja veten. Kalova një vit tjetër në Oksford, jo në universitet por duke jetuar aty dhe duke punuar për të fituar paratë për të paguar për t'u bërë mësuese. Kam punuar në një shkollë të veçantë, një shkollë me fëmijë me nevoja të veçanta si asistente në shkollë. Por pastaj kam punuar në një bar dhe pastaj si pastruese, e dini, kam bërë shumë punë duke provuar të... gjithashtu kam punuar në *Oxford University Press*, në shtëpinë botuese. Pra, kam bërë çfarë kam mundur për të fituar para në mënyrë që të mund të paguaja vitin tjetër jetën në Londër dhe trajnimin për t'u bërë mësuese.

Erëmirë Krasniqi: A ishte ky viti pas universitetit?

Elizabeth Gowing: Po, saktë.

Erëmirë Krasniqi: A fillove të japësh mësim pastaj apo...

Elizabeth Gowing: Po...

Erëmirë Krasniqi: Me ndonjë praktikë...

Elizabeth Gowing: Kisha punuar si asistente në shkollë. Pastaj shkova në kolegjin e mësuesisë ku ka shumë punë praktike. Pastaj menjëherë morra një punë në Londër. Dhe pastaj fillova të jap mësim, e dini, me orar të plotë në një shkollë me shumë vështirësi në Londër. Kjo ishte e mrekullueshme, kisha

shumë energji për atë punë dhe e doja shumë. Ishte dërrmuese por ishte diçka, ndihesha sikur ajo ishte diçka që doja të bëja me jetën time kështu që...

Erëmirë Krasniqi: Për cilat vite po flasim?

Elizabeth Gowing: Pra, në vitin '96 kam marrë çertifikatën. Dhe pastaj, po, saktë, '96... pastaj kam punuar në disa shkolla të ndryshme dhe... gjithashtu kam kryer disa role menaxhuese në shkolla. Kam marë rolin e zëvendës-kryetares së shkollës dhe pas kësaj pata vendosur të mos jap mësim me orar të plotë por të punoj edhe në politika. Kështu që kam punuar në edukim por duke këshilluar qeverinë, duke punuar në një organizatë profesionale të mësuesve. Pas kësaj kam vazhduar të jap mësim me gjysëm-orar sepse dëshiroja të vazhdoja të kem lidhje me fëmijët dhe klasën. Pra, kam dhënë mësim njëherë në javë.

Dhe kjo është ajo që kam bërë. Pas këtyre dhjetë vjetve, një ditë Rob tha, “A e kupton se asgjë nuk mund të na ndalojë të bëjmë saktësisht këtë që jemi duke e bërë tani për pjesën e mbetur të jetëve tona?” Dhe anipse ishim të lumtur, nuk është se nuk ishim të lumtur me punët tona dhe me Londrën e njëri-tjetrin... thjesht dëshironim një ndryshim, e dini. Dhe pastaj vendosëm se nuk dëshironim të kishim fëmijë. Dhe gjithë miqtë tanë filluan të kenë fëmijë, kështu që mund ta shihja se ne do të vazhdonim të bënim gjërat e njëjta, të vjetra... Dhe pastaj vendosëm të dalim jashtë shtetit për punë vullnetare. Kështu që dërguam CV-të tona në shumë organizata humanitare në Afrikë e Azi. Menduam të bëjmë ndoshta një vit punë vullnetare por në të njëjtën kohë Rob ishte duke punuar me qeverinë britanike. Kështu që ai u dërgoi një letër elektronike njerëzve që i njihte nëpër ambasada dhe gjithë atyre me të cilët kishte kontakt ku iu tha, “Nëse dëgjoni për ndonjë OJQ që mund të dojë vullnetarë, unë dhe Elizabeth duam të bëjmë punë vullnetare”.

Pastaj ambasada në Kosovë u përgjigj, na kontaktuan dhe thanë, “Nuk dijmë për ndonjë punë vullnetare por mendojmë se kryeministri i ri dëshiron një këshilltar britanik dhe mendojmë se do të mund ta bënit këtë punë”. Kështu që Rob erdhi në shtëpi një ditë dhe tha, “E di, çfarë mendon, të shkojmë në Kosovë për gjashtë muaj?” Kjo ishte njëmbëdhjetë vjet më parë (qeshë). Ai tha se do të vinim për gjashtë muaj.

Dhe për të qenë e sigurtë, Kosova ishte shumë afër dhe nuk ishte ajo që ne ishim... ne pritnim të shkonim diku më larg. Diku në një vend më ekzotik dhe shumë më ndryshe, por ishte në rregull, nuk kishim marrë ende asnjë përgjigje nga aplikimet për punë vullnetare që kishim bërë, kjo ishte një mënyrë e sigurtë. Na dukej më e sigurtë sepse ishte me pagesë dhe nuk do të na duhej të hiçnim dorë nga gjithçka sepse ishte vetëm për gjashtë muaj, kështu e mendonim (qeshë) kështu që thamë, “Po, po e bëjmë!” Dhe gjithçka ndodhi shumë shpejt kështu që dhjetë ditë pas kësaj oferte, shtëpia jonë u paketua dhe pas dhjetë ditësh ishim këtu. Nuk ishte bash ashtu siç e kishim planifikuar.

Erëmirë Krasniqi: Si ishte? Si ishin përshtypjet tuaja të para? Çfarë ishte... (qeshë).

Elizabeth Gowing: Përshtypjet e para ishin shumë të mira, përndryshe nuk do të kisha qëndruar. Po mendoj, nuk ishte ashtu siç e kisha imagjinuar se do të ishte. Mendoj se të gjithë befasohen nga Kosova, të gjithë ata që vijnë nga Britania. Sepse imazhet e Kosovës, i gjithë informacioni rreth Kosovës është rreth luftës, refugjatëve dhe ndoshta korrupsioni apo... kështu që vjen këtu duke pritur

një vend që do të jetë i dëmtuar fizikisht nga lufta. Sidomos në vitin 2006 i cili është viti kur ne kemi ardhur, vetëm shtatë vjet kishin kaluar. Kam menduar se do të shoh ndërtesa me plumba. Dhe mendoj se isha disi dyshuese në njerëz, prisja që të jenë të pasinqertë ose të pabesueshëm apo...

Më kujtohet në ditën tonë të parë në hotel kur dikush na ofroi të na ndihmonte, kam menduar me veten se ai person nuk dukej i besueshëm, e dini. Nëse dikush është shumë mikpritës dhe i ngrohtë e ndihmues dhe kam menduar me veten, ndoshta duhet të ndryshoj atë që jam duke pritur nga ky vend. Dhe secili person që e kam takuar këtu ma ka ndryshuar mendimin ngapak, sikur, “Ke pasur idenë e gabuar”. Dhe lufta nuk ishte shumë e dukshme, e dini. Nuk kishte shtëpi me vrima plumbash, natyrisht lufta është ende pjesë e identitetit të njerëzve dhe përvojave të tyre por nuk është pjesë e peisazhit fizik, jo në vitin 2006, aq më pak tani. Kështu që e gjithë kjo ishte befasuese, ishte një shtet më ndryshe.

Dhe më kujtohet se në ditën e parë këtu, ishim në hotel dhe Rob shkoi të takojë kryeministrin Agim Çeku dhe unë mbeta në hotel duke mos e ditur çfarë do të bëja. Më kujtohet vetja duke shikuar nga dritarja, ishim në “Hotel Baci” i cili është mbyllur tani. Por aty ishte një bllok ndërtesash, dyqanesh, ndërtesash përballë dhe unë thjesht shikoja banesën përballë duke menduar, “A thua kush jeton aty dhe si është jeta e tyre, kush janë këta njerëz?” E dini, dëshiroja të njihja realitetin e jetës së tyre. Dhe jam shumë e kënaqur që jam pranuar në jetët e njerëzve këtu ashtu që të mund të bëj një gjë të tillë. Të premtën e parë, pra ne kemi arritur të hënën dhe të premtën na kanë ftuar për darkë një çift kosovar me të cilët punonte Rob. Mendoj se javën në vijim ishim ftuar në shtëpinë tonë të parë kosovare. Brenda tri javëve kishim shkuar në dasmën e parë (qeshë), njerëzit të ftojnë shumë shpejt...

Erëmirë Krasniqi: Ku keni jetuar? Cila ka qenë shtëpia juaj e parë këtu?

Elizabeth Gowing: Në Prishtinë? Dasma e parë ishte në Podujevë, në fshatin Lupç i Poshtëm. Ajo në Podujevë ishte tamam një dasëm kosovare fshati, e dini, e bukur, e shumë vallëzim dhe të gjithë e rroba tradicionale dhe ishte shumë...

Erëmirë Krasniqi: Si ishte kjo? A mund ta përshkruani?

Elizabeth Gowing: Po, ishte mrekullueshëm. Ishte një familje të cilën në fakt e kisha takuar në Londër gjatë kohës kur isha duke dhënë mësim në vitin 1999. Një familje kosovare erdhi në shkollën tonë dhe unë iu ndihmova, ata kishin disa fëmijë, njëri prej tyre ishte në klasën time dhe pata menduar se mund t’iu ndihmoja të vendoseshin. Dhe kam mbajtur kontakt me atë familje edhe pasi fëmijët u larguan nga shkolla. Kështu që kur dëgjuan se do të vija këtu ata ishin mrekulluar dhe unë isha mrekulluar për faktin se kisha një lidhje, kështu që ata me shumë mirësjellje më vunë në kontakt me tezen e tyre e cila jetonte këtu, me të cilën ende jam në kontakt, Elmaze Pireva, e cila për çudi tani është në Londër (qeshë). Kështu që disi, u ndërruam.

Dhe daja i tyre po martohej kështu që më ftuan në dasmë dhe nuk e kisha kuptuar kur kam arritur por disi aty më trajtuan si mysafire nderi. Isha shumë, më vendosën në veturë me dhëndrrin dhe me motrën e tij dhe kur ishte kanagjegji, më ftuan të vallëzoj. Ky ishte vallëzimi im i parë vetëm (qeshë),

m'u desh të ngritesha në këmbë e t'i çoj duart lartë në ajër {shpjegon me gjeste}, dhe disi të dridheshja (qeshë), ishte paksa e frikshme, por natyrisht, shumë mikpritëse.

Erëmirë Krasniqi: Në cilën pjesë të qytetit keni jetuar?

Elizabeth Gowing: Kemi jetuar afër Ministrisë së Arsimit, ndërtesës së vjetër, e cila është prapa Ben-Af-it, kjo është një mënyrë shumë prishtinalike e të orientuarit (qeshë). Nuk e di... disi afër Ulpianës, por në anën e kundërt. Sidoqoftë ishte një shtëpi shumë e mirë me një kopësht të vogël dhe ndiheshim shumë me fat aty. Shtëpia paguhej nga qeveria britanike kështu që ishte shumë më mirë sesa ajo në të cilën kishim jetuar në Londër dhe më e mirë se ajo në të cilën jetojmë tani (qeshë). Por ishte një vend shumë gazmor për ta bërë shtëpi dhe ishte bosh kur u futëm ne në të, nuk kishte fare mobilje. Ne nuk kishim mobilje poashtu, në fakt kishim shumë pak mobilje.

Në fakt kjo ishte mënyrë e mirë për të eksploruar Kosovën, sepse m'u desh të shkoja e të mësoja fjalën *garnishte* [shqip] (qeshë). Më është dashur të shkoj të gjej një *zdruckhtar*, *zdruckhtari* [shqip] ishte një prej fjalëve të mia të para, e cila është një fjalë me të vërtetë e vështirë. Dhe ai bëri disa tavolina e rafta për ne dhe bëmë gjithçka nga fillimi. Ky ishte projekti im për arsye se unë nuk kisha punë, dhe kështu e kam mësuar shqipen. Kisha disa leksione, por kjo është mënyra se si e kam praktikuar shqipen dhe normalisht fjalët *garnishte* dhe *zdruckhtar* nuk janë fjalët e para që mësohen (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: A e ke mësuar [shqipen] këtu apo...

Elizabeth Gowing: Po, po. Ne kishim vetëm tri javë përpara se të vinim këtu pra... Rob pati marrë disa mësim në Angli dhe pastaj m'i pati mësuar edhe mua disa fjalë. Por me vetëm tri javë për t'u përgatitur, nuk kishim kohë të përgatiteshim. Kështu që kishim fatin ta kemi mësuesin e mirë Gazi Bërlajollin i cili punoi me ne një-me-një dhe kjo ishte shumë e mirë, mënyra e të mësuarit rreth këtij vendi.

Erëmirë Krasniqi: Për sa kohë e keni mësuar, sa kohë iu ka marrë?

Elizabeth Gowing: Ende jam duke mësuar (qeshë). Më kujtohet, kisha qenë këtu për një vit, kam punuar për Save the Children, për një kohë të gjatë kam qenë konsulente për Save the Children. Dhe në verën e parë pasi që kishim ardhur këtu, kam bërë një trajnim për mësuesit për Save the Children dhe ata më ofruan një përkthyes si zakonisht dhe iu thashë, "E dini se kam nevojë për përkthyes, natyrisht, nuk flas shqip rrjedhshëm. Por përkthyesit gjithmonë e ngadalësojnë punën, e dini. Duhet thënë gjërat dy herë dhe ndonjëherë përkthyesi nuk e kupton atë që dua të them. Mendoj se jam në fazën ku disavantazhet e të pasurit një përkthyes janë më të mëdha se avantazhet, mund ta bëj edhe vetëm, natyrisht e di se do të bëj gabime por do t'ia dalim". Dhe kjo për mua është dukur si një ditë tepër e madhe, të jem e aftë të bëj një trajnim pa përkthyes. Kështu që atë ditë jam ndier sikur të isha mësuar të flas shqip, natyrisht jo rrjedhshëm, por mjaftueshëm. Por me të vërtetë, ende jam duke mësuar. Kam një fletore në të cilën shkruaj fjalë, fjalë të reja çdo ditë dhe e dini është...

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Si vendosët të qëndroni këtu pas gjashtë muajve?

Elizabeth Gowing: Na pëlqente shumë këtu kështu që thamë se do të na pëlqente të vazhdonim këtu dhe kështu Rob kishte mundësi ta zgjaste punën dhe e bëri dy-tri herë. Ai ka punuar edhe me Hashim Thaçin kur u bë kryeministër. Pastaj iu ofrua një punë tjetër në Londër, përsëri për të punuar me qeverinë britanike, kështu që ai u kthye në Londër, u kthyem bashkë në Londër por mbajtëm një dhomë dhe një shtëpi këtu. Jo shtëpinë që kishim pasur më parë por vetëm një dhomë të vogël sepse unë vazhdova të punoj me Save the Children dhe kështu lëvizja herë këtu herë atje, ndoshta çdo të gjashtën javë.

Pra ende kishim një bazë këtu, por jo me orar të plotë, edhe Rob vinte nganjherë, kjo gjë ka vazhduar për disa vjet. Pastaj Rob aplikoi për një punë në ICO, kur ICO ishte këtu, kështu që u kthyem për të jetuar këtu përsëri. Dhe pastaj ai fitoi një punë tjetër në Shqipëri, prandaj kjo është arsyeja pse tani unë e ndaj kohën time në tri pjesë. Ende kemi një shtëpi me qira këtu në Pejton dhe vijmë këtu për t'i mbajtur gjërat në vazhdimësi me Ideas Partnership, me OJQ-në tonë, dhe për t'u takuar me miq e...

Erëmirë Krasniqi: Do të kalojmë aty, gjithë jetën tënde... A mund të na përshkruash [a mund të na japësh] më shumë detaje, të lutem?

Elizabeth Gowing: Nga jeta në Kosovë? Pra, po, po. Epo...Pra...

Erëmirë Krasniqi: Duhet të ketë qenë periudhë shumë kritike, po mendoj, ky tranzicion... nuk janë shumë të lehta tranzicionet dhe vetëm dy vjet larg 2004-tës, dhe para kësaj, vetëm pak para kësaj (qeshë)...

Elizabeth Gowing: Po, saktësisht...

Erëmirë Krasniqi: Goxha delikate.

Elizabeth Gowing: Më kujtohet që na patën thënë të mbajmë një çantë gati në rast se do të kishte nevojë për t'u evakuar shpejt dhe të kishim rroba sportive në të, poashtu një shishe me ujë dhe ilaçe... dhe e dini, pak para.

Vitin e parë dukej sikur të jetoje në një vend ku gjërat mund të bëheshin të frikshme për arsye se njerëzve iu kujtohej si kishte qenë 2004-ta dhe natyrisht, 1999-ta. Por po, jam shumë e lumtur, mirënjohëse që nuk na është dashur kurrë të bëjmë diçka të tillë. Dhe pastaj ne ishim, po mendoj se ishim këtu për pavarësi dhe kjo ishte diçka tepër e mirë. Po mendoj, ishte shumë e bukur për ne, nuk mund ta imagjinoj si ka qenë për njerëzit të cilët kanë qenë këtu me gjenerata të tëra. Por për ne kjo dukej si një arritje dhe pikë orientuese. Natyrisht, ndoshta kjo nuk ishte e vërtetë por e dini, puna e vërtetë duhej të fillonte pas pavarësisë. Por mendoj se, e gjithë kjo ishte shumë interesante sidomos për Rob, kjo ishte e rëndësishme për punën e tij por puna ime nuk ishte edhe aq e lidhur me atë.

Isha e lumtur që kisha mundësi të bëja gjëra si për shembull, kam bërë punë vullnetare në muzeun etnologjik dhe kjo ishte diçka shumë e mirë. Kam bërë miq të mirë dhe ishte ndërtesë tepër e bukur dhe një vend në të cilin edhe sot kur eci jam shumë e lumtur dhe më krijon ndjesinë e të qenit në vendin e duhur. Gjithashtu kjo ka qenë një mënyrë përmes të cilës kam mësuar shumë për historinë dhe kulturën e Kosovës, e keni parasysh, për artizanatet dhe gjëra të tjera që më interesojnë.

Erëmirë Krasniqi: Në çfarë kapaciteti je përfshirë?

Elizabeth Gowing: Kam bërë... jo, nuk e kam ditur që diçka e tillë ishte bërë tashmë. Muzeu është hapur pothuajse saktësisht në kohën kur unë kam ardhur këtu. Kështu që kam qenë aty përgjatë gjithë jetës time kosovare, por i kam mësuar anglisht udhërrëfyesit të muzeut, pra kam mbajtur orë të gjuhës angleze. Pastaj i kam ndihmuar të aplikojë për disa fonde dhe kemi marrë një grant nga ambasada britanike për një javë për rezidentë dhe artistë. Kjo ngjarje ishte në fakt shumë e mirë, kemi ftuar artistë të vijnë dhe të jenë në muze për një javë e të pikturojnë dhe bëjnë skulptura apo vepra të tjera përgjatë kohës sa kanë qëndruar aty. Pastaj puna e tyre është shfaqur në fund të javës dhe kemi fituar më shumë para sesa që kishim shpenzuar për organizimin e ngjarjes, kështu që ishte shumë mirë... ishte një nismë e mirë. Pastaj kemi bërë një projekt fotografie në atë kohë dhe pastaj stafi i cili, e dini, morri gjërat nën kontroll pasi që kishim dëshmuar se kishte...

Kishte shumë njerëz që e donin me të vërtetë atë muze. Mendoj se kjo gjë i ka motivuar më shumë për të parë se të qenit eksperimental dhe kreativ ia vlente dhe kështu ata patën shumë sukses. Kemi bërë panairin e parë të artizanateve, njerëz artizanë patën ardhur për të demonstruar aftësitë e tyre çdo ditë përgjatë një jave dhe në fund të panairit dhe aktiviteteve... Ky aktivitet vazhdon ende dhe është shumë, shumë më i madh tani dhe kanë bërë gjëra të mrekullueshme me të. Kështu që, më ka pëlqyer ta bëj gjithë këtë.

Gjithashtu kam bërë, kam marrë të huaj të trajnuar të cilët kishin ardhur këtu për të dhënë mësim të gjuhës angleze pas shkollës. Kështu që kishim pesë shkolla nëpër Prishtinë ku kishim klube, klube të gjuhës angleze. Kishim një lloj kurrikule të shkurtër dhe kjo ishte shumë qejf. Mbrëmë jam takuar me njërin nga vullnetarët e mi i cili ka qenë vullnetar në këtë projekt dhe ai ende vazhdon të mbajë kontakte me familjen, me njërin nga djemtë të cilët ai i ka mësuar gjuhë angleze. Ai i thërret ata "Familja ime kosovare" dhe është diçka shumë e bukur kur e mendon, e ke parasysh. Kjo ishte, e ke parasysh, sa vjet më parë ka ndodhur kjo gjë? Nëntë vjet më parë, dhe ai ende mban kontakte me ta. Kështu që, kjo ishte ajo me të cilën isha e zënë, dhe nuk lidhej me pavarësinë.

Erëmirë Krasniqi: A ke pasur jetë sociale? Miq?

Elizabeth Gowing: Po, shumë miq. Unë edhe Rob jemi *kumbar* [shqip] dhe *ndrikulla* [shqip], jo në kuptimin religjioz të fjalës, të vajzës së miqve tanë shumë të mirë Alisa dhe Burim, të Adenës. Dhe kjo ishte shumë e rëndësishme për neve sepse është disi një lidhje formale, kemi bërë ceremoninë formale të prerjes së flokëve, e keni parasysh. Ajo familje, dua të mendoj se ajo familje është pjesë e familjes tonë ose ne jemi pjesë e familjes së tyre. Kemi mjaft miq të mirë. Dhe tani me punën që e bëjmë përmes The Ideas Partnership, ka shuëm familje të cilave iu kemi ndihmuar dhe me të cilat jemi të lidhur në mënyrë shumë fundamentale, kështu që, po, kemi jetë sociale...

Erëmirë Krasniqi: Si e keni filluar OJQ-në?

Elizabeth Gowing: Kishim filluar të bëjmë projekte të vogla, siç thashë, puna me muzeun etnologjik apo klubet e anglishtes, dhe të gjitha këto ishin... nuk kishim OJQ, nuk kishim fonde. Ishte thjesht punë vullnetare dhe njerëz të tjerë kryenin punë vullnetare, por pas disa vjetësh, e kuptuam që dëshironim të aplikonim për gjëra, për shembull si ajo e rezidentëve të muzeut, kishim nevojë për një

llogari bankare dhe duhej të ishim transparentë. Njerëzit filluan të na jipnin para sepse iu pëlqente ajo që bënim, kështu që dikush për shembull na jipte 50 euro për punën ose për bamirësi, ato i futnim në zarf dhe e shkruanim në zarf, por kjo gjë nuk ishte shumë transparente. Kështu që, vendosëm të regjistrohemi si OJQ.

Jemi bashkuar me mikun tonë Ardian Arifaj, dhe ne të tre, unë, Rob dhe Ardi regjistruam The Ideas Partnership në vitin 2009. Por nuk kishim plane të mëdha për të dhe nuk kishim ndonjë projekt të caktuar në mendje. Ishte thjesht... kishim një organizatë. Dhe prandaj zgjodhëm këtë emër, The Ideas Partnership, në mënyrë që të jemi neutralë, e ke parasysh. Emri nuk tregonte se ne punonim me ambientin apo trashëgiminë kulturore apo edukimin... vetëm se këto ishin tri temat tona, thjesht na duhej një motor.

Dhe pastaj kemi bërë... nuk ka qenë projekt i madh, më duket se pati kushtuar 2000 euro ose diçka e tillë, ishte projekt goxha i vogël por e kemi organizuar një kamp ambientalist në Rugovë. Kemi punuar me dy organizata tjera për atë. Por në mënyrë indirekte, ai kamp na ka sjellur tek gjithçka tjetër sepse kampi veror kishte... ishte një kamp shumë-etnik, kishte shqiptarë, boshnjakë, romë, ashkali dhe egjiptas. Dhe njëra nga punët e mia ishte të punoj me fëmijët përgjatë kampit në mënyrë që ata të kenë një projekt të cilin do të donin ta implementonin pas kampit.

Dhe pas kampit, puna ime ishte të shkoja të vizitoja këta fëmijë nëpër Kosovë dhe t'i ndihmoj të bëjnë... disa gjëra shumë të vogla, për shembull njëra prej tyre ishte vendosja e shportave të mbeturinave në këndin e lojërave në oborrin e shkollës, ku fëmijët mund t'i hidhnin mbeturinat. Kisha një grup nga Fushë Kosova, romë, ashkali dhe egjiptas, të cilët dëshironin të mbillnin një kopësht të vogël në komunitetin e tyre.

Kështu që shkova u takova me ta në shtëpitë ose në komunitetin e tyre. Dhe kjo ishte hera e parë që unë shkova në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë dhe mbeta me të vërtetë e shokuar. Edhe pse në atë kohë kisha qenë këtu për pesë vjet dhe... katër vjet, dhe kisha dëgjuar për kushtet e romëve, i dija statistikën por në fakt kurrë nuk kisha qenë në një komunitet për të parë mbledhësit e mbeturinave dhe varfërinë, sidomos kur e njeh Prishtinën nga kafiteritë dhe një fluskë ndërkombëtare, përsëri fluskë. Kjo gjë më ka bërë të dua të punoj me atë komunitet. Kemi pasur disa gjëra të mbetura nga kampi, disa çanta për fjetje dhe pjata... nuk e di, gjëra të rëndomta. Dhe kam menduar se mund t'i jipja ato për këto familje në nevojë sepse e pashë që ata kishin vërtetë nevojë.

Kështu që iu kërkova të më dërgojnë tek familjet më të varfëra në komunitet, u thashë se dëshiroja t'ua jipja ato gjëra vetë sepse ato na ishin dhënë neve si donacion dhe unë doja të jipja njëfarë llogarie mbi atë se ku shkonin gjërat. Dhe ndodhi që njëra prej familjeve të cilave iu dërgova gjërat, fëmija i vogël i familjes i cili ishte tri vjeç në atë kohë, kishte qenë duke luajtur në një shtëpi tepër të vogël dhe të stërbushur me njerëz dhe kishte tërhequr një tenxhere me ujë të vluar nga stufa dhe kishte djegur veten shumë keq. Dhe kështu shkova për të dhuruar çantat për fjetje dhe pjatat e gjërat e tjera të rëndomta tek kjo familje dhe ata thanë, "Faleminderit shumë, por a mund ta ndihmosh birin tonë?" Dhe unë thashë, e keni parasysh, "Unë nuk mund t'i ndihmoj, nuk di çfarë të bëj për t'i ndihmuar birit tuaj".

Ai tashmë kishte qenë në spital, pra ngjarja nuk kishte ndodhur në atë moment. Por më thanë se i duhej një operacion për arsye se lëkura e tij ishte djegur shumë dhe ai nuk mund të ecte mirë për arsye të ngushtimit të lëkurës së tij, dhe unë thashë, “Më falni, unë jam mësuese, nuk jam mjekë”. Dhe u largova. Nuk mund të largohesha shumë sepse, ai ishte... trupi i tij ishte tepër i dëmtuar. Kështu që e thirra mikeshën time, Mary e cila kishte... një grua britanike e cila kishte qenë mjekë këtu për një kohë të gjatë dhe i thashë, “Çfarë mund të bësh për t’i ndihmuar? Ose çfarë mund të bëj unë për t’i ndihmuar? Si është sistemi?” Dhe ajo më tha, “Nëse ka qenë në spital, ata duhet të kenë dokumente dhe emri i mjekut duhet të jetë në to, dhe mund të biesh në kontakt me atë doktor”.

Kështu unë u ktheva tek familja dhe iu thashë, “Në rregull, më tregoni flet *fletëlëshimin* [shqip], apo çfarëdo që keni nga spitali”. Dhe natyrisht ky dokument kishte vulën me emrin dhe numrin e mjekut. Kështu e kontaktova mjekun dhe i thashë, “Çfarë mund të bëjmë?” Dhe, histori e gjatë por në fund shkova me djalin e vogël dhe nënën e tij, Hetemen. Dhe jo që kishte rëndësi ishte fakti se mjeku në fakt tha se asgjë nuk mund të bëhej me operacionin tash për arsye se ai ishte shumë i vogël dhe lëkura e tij duhej të mbahej e ushqyer në mënyrë që të mund të operohet. Dhe gjithçka që duhej ishte një kremë për të lyer lëkurën çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje. Kremi kushtonte nëntë euro që nuk është shumë e madhe por familja e tyre... babai i tij ishte mbledhës mbeturinash, kështu që ishte e pamundur. Kështu unë thashë, në rregull, unë mund të blej kremin. Dhe iu thashë, “Më lajmëroni kur të shpenzohet dhe do të vij t’iu sjell një të ri”.

Dhe ky doli të jetë momenti më domethënës i kohës sime në Kosovë. Sepse kuptimi i saj ishte se çdo dy javë, ata më telefononin dhe unë shkoja bleja kremin dhe e vizitoja familjen. Në fillim thjesht iu jipja kremin, pastaj herën tjetër më ftuan brenda dhe herën tjetër më dhanë çaj dhe herën tjetër, e keni parasysh, komshinjtë vinin dhe kjo është mënyra se si u bëra vërtetë pjesë e atij komuniteti.

Nuk kam shkuar atje me idenë e një projekti apo idenë e hapjes së një qendre, apo për të bërë ndonjërin nga gjërat që bëjmë tani. Por thjesht sepse më ka rënë të dëgjoj rreth, “Oh, këta fëmijë kanë nevojë të shkojnë në shkollë, këta kanë nevojë për këpucë dhe kjo është... këta fëmijë nuk janë të vaksinuar, prandaj le të bëjmë diçka për këtë gjë”. Dhe kjo është me të vërtetë mënyra se si nisi puna jonë atje. Ishte shumë natyrale dhe organike.

Erëmirë Krasniqi: Pra, gjithçka ka filluar nga kjo familje?

Elizabeth Gowing: Po. Me atë familje, po. I vizitohet sa herë jam në Kosovë, i vizitohet ata. Sapo isha... prej atje po vij tani sot (buzëqeshë). Sepse në fakt isha...

Erëmirë Krasniqi: A ishte edhe Gjejlanya pjesë e kësaj familje?

Elizabeth Gowing: Po, saktësisht! Është motra e atij djalit të vogël. Kam shkuar nga... Gjejlanya nuk ishte në shkollë... në fillim ishin vëllezërit e saj. Vëllezërit nuk ishin në shkollë dhe kishin nevojë për këpucë kështu që unë iu bleva këpuca dhe për kaq kishin nevojë. Ende janë në shkollë, shtatë vjet më vonë këta djem kanë shkuar... janë ende në shkollë. Thjesht isha duke biseduar me ta në një pasdite dhe mendova se kjo ishte gjithçka që iu nevojitej, mendoja me veten, “Në rregull, këpucë. Mund të sigurojmë këpucë për aq fëmijë sa iu duhen”. Pastaj Gjejlanya më tregoi se nuk ishte në shkollë, ajo

ishite nëntë vjeç në atë kohë dhe thashë, “Do të të blej këpucë”. (qeshë) E dija zgjidhjen për këtë problem. Ajo tha, “Jo, është shumë vonë. Nuk më pranojnë më në shkollë.”.

Dhe nuk mund të besoja se kjo gjë ishte e vërtetë. Mendova se ajo thjesht po gjente një justifikim, kështu që, shkova në shkollë dhe thashë, “Duhet të ketë një keqkuptim këtu sepse është një vajzë nëntë vjeçare e cila dëshiron të shkojë në shkollë por mendon se është shumë vonë”. Dhe në shkollë më thanë, “Jo, jo, është shumë... është shumë vonë për të, për të ardhur në shkollë tani”. Pastaj shkova në ministri dhe thashë, “E keni një drejtor që nuk kupton sepse po thotë që vajza nuk mund të shkojë në shkollë”. Dhe ata në ministri më thanë, “Po, ai ka të drejtë”. “Është e vështirë t’i mësoni ata”, më thanë.

Ky është momenti kur i thashë Gjejlanes, “Në rregull, unë do të të jap mësim”. Dhe pastaj ajo më tha, “Mirë, a mund të vijë disa nga miqtë e mi?” Dhe kështu filluam të punojmë me ta. Dhe pastaj kemi Gjejlanen...

Erëmirë Krasniqi: A keni punuar me komunitetin në gjuhën shqipe?

Elizabeth Gowing: Po, po, po, në shqip. Dhe pastaj e dërguam në shkollë, i dërguam të gjithë në shkollë. I kemi dërguar 62 fëmijë në shkollë në vitin 2011. Pastaj e kuptuam se duhej t’i mbanim në shkollë, gjë kjo pak më e ndryshme. Kështu që nisëm disa projekte, duke përfshirë punën me nënat për të ofruar... një ndërmarrje sociale, në mënyrë që nënat të mund të fitojnë pak para dhe fëmijët pastaj të mos kenë nevojë të dalin për të lypur apo për të mbledhur mbeturina. Kjo është ajo që vazhdojmë ta bëjmë tani.

Dhe pastaj, kjo familje ende nuk kishte shtëpi ose në fakt po jetonin në vetëm një dhomë dhe ishte e tmerrshme. Një ditë, djali më i ri i familjes erdhi në aktivitetet tona dhe kishte një shenjë {prekë faqen} në faqe. Dhe i thashë, “Çfarë ka ndodhur?” Ai më tha, “Minjtë më kanë kafshuar natën”. Dhe thashë në rregull... kjo gjë nuk është e mirë, e dini, i kishim bërë gjithë ato gjëra të mira. Kishim vaksinuar fëmijët, kishim punësuar nënat në ndërmarrje sociale, të gjithë fëmijët ishin në shkollë, të gjithë kishin këpucë. Por nëse ata jetonin në një dhomë me minjë dhe fëmijët kafshohen gjatë natës, atëherë ne nuk paskemi arritur asgjë. Dhe është paksa hipokrite të themi, “Shihni çfarë pune të mrekullueshme kemi bërë”. Kur familja jeton në atë mënyrë.

Dhe u ndjeva tepër e thyer sepse dëshiroja ta ndihmoja atë familje por pastaj mendoja, e dija se kishte tepër shumë familje. Dhe ajo ishte njëra prej familjeve në gjendjen më të vështirë, për arsye se shumë veta jetonin në një dhomë tepër të vogël dhe ky kishte qenë shkaktari që djali i vogël kishte tërhequr ujin e vluar mbi veten, kjo kishte ndodhur për shkak të atij vendi aq të vogël. Por prapë mendoja se The Ideas Partnership nuk mund të shkojë dhe të ndërtojë një shtëpi vetëm për një familje, kjo nuk do të ishte e drejtë, dhe nuk mund t’i justifikojmë ato para. Por pastaj shoqja ime Nikola erdhi për të vizituar dhe ajo erdhi me mua për të vizituar familjen, dhe kur u largua tha, “Nuk mund t’i lëmë të jetojnë këtu, kjo është e tmerrshme. Çfarë mendon, të ngrisim fonde dhe e dini, mund të më ndihmosh por nuk do ta bësh këtë përmes The Ideas Partnership, vetëm përmes teje”.

Kjo ishte tepër domethënëse sepse ajo pastaj u aktivizua, shfrytëzoi të gjithë miqtë dhe kontaktet e saj. Shfrytëzoi Facebook-un dhe ngriti fonde për të blerë tokë për ta. Dhe pastaj Mercy Corps

ndërtuan... thanë se do të ndërtojnë një shtëpi në tokë, nëse ne do të blinim tokën, ata do të ndërtonin shtëpinë. Kështu që e bëmë gjithë këtë punë para tre vjetësh. Duhet të ketë qenë saktësisht para tre vjetësh që ata u vendosën në shtëpinë e tyre të re dhe ata ishin familja më fatlume, më e lumtur në Fushë Kosovë.

Pastaj pas tre muajsh, babai i tyre përjetoi një sulm në zemër dhe vdiq duke lënë gjashtë fëmijë të cilët në atë kohë ishin prej tre deri në trembëdhjetë vjeç. Gjejlanya ishte trembëdhjetë vjeç. Pra nga të qenit familja më fatlume dhe më e lumtur, dhe ne kishim menduar disi se ata tashmë ishin në rrugën e tyre, i kishim zgjidhur gjërat dhe ata ishin të aftë të kujdesen për veten, papritmas ata u bënë një familje tepër fragile. Hetemes iu desh të kujdesej për të vegjlit, kështu që nuk kishte mundësi të dilte të mbledhte mbeturina. Djali më i vjetër... ditën kur i vdiq babai ai më tha, "Tani më duhet ta lë shkollën, duhet të mar karrocën dhe të dal për të mbledhur mbeturina". Unë i thashë, "Jo, babai yt nuk dëshironte një gjë të tillë, e ke parasysh, babai yt dëshironte që ti të shkoje në shkollë".

Kështu që kemi provuar t'i mbështesim në mënyra të ndryshme dhe kemi bërë një projekt në kuadër të The Ideas Partnership, në emrin e Agron Krasniqit, babait të tij. Dhe pastaj, ky është fondi i të vejave, pra është për të mirën e familjes së tij por edhe të familjeve të tjera të grave të veja. Unë nuk e kisha kuptuar sa fragile është një familje kur i vdes babai, sidomos nëse fëmijët janë ende të vegjël dhe nëna nuk mund të dalë të punojë edhe nëse do të ishte e lehtë për të për të gjetur punë. Dhe natyrisht ata nuk kishin para të kursyera dhe nuk kishin ushqim në pjata, e dini. Nuk kishin asgjë, nga ajo ditë ata nuk kishin asgjë.

Nuk kisha menduar më parë për domethënien e kësaj dhe natyrisht është djali më i vjetër ai që do të duhej të linte shkollën për të punuar, përpos nëse dikush tjetër do të ndihmonte familjen. Kështu ne praktikisht kishim filluar duke provuar të mbështesim një djalë të vogël tre vjeçar i cili ishte djegur, dhe pastaj kishim zbuluar çështjen e shkollimit. Kështu filluam shpërndarjen e rrobave, iu blemë fëmijëve këpucë në mënyrë që të mund të shkonin në shkollë, pastaj na ra të përballemi me këtë çështje, pra për t'i lejuar fëmijët të shkojnë në shkollë. Pastaj filluam ndërmarrjen shoqërore në mënyrë që nënat të mund të fitojnë para ashtu që fëmijët e tyre të mund të vazhdonin të shkonin në shkollë. Dhe tani bëjmë shumë gjëra atje, jemi duke u munduar të gjejmë mënyra për t'i bërë vetë anëtarët e komunitetit më shumë agentë të ndryshmeve për vete.

Pra kemi vizionin se... e tri niveleve të ndihmës së njerëzve në nevojë, pra dhënia e kemit për djegien e Ramadanit, dhe ndihma ndaj njerëzve në nevojë për t'i mësuar ata të ndihmojnë veten, dhe natyrisht kjo është ajo që bëjnë të gjitha organizatat bamirëse, dhe kjo shpesh ka të bëjë me edukimin dhe gjithë punën që kryen ndërmarrja shoqërore. Por pastaj niveli i tretë, i cili mendoj se është goxha i pazakontë për punën tonë, është jo vetëm ndihma për njerëzit në nevojë dhe mësimi i njerëzve në nevojë për të ndihmuar veten, por ndihma ndaj njerëzve në nevojë për të ndihmuar njerëz të tjerë në nevojë. Kjo shë... e keni parasysh, pa marrë parasysh sa i varfër je, mund të jesh dikush që mund të ndajë diturinë tënde apo diçka tjetër... për shembull, ne kemi një skemë bursash, kështu Agroni ishte në atë skemë para se të vdiste papritmas, për të rritur, njerëzit si Agroni në të tridhjetat e tyre mund të ktheheshin në shkollë, shkollë nate në mënyrë që të mund të merrnin diplomën e shkollës së mesme.

Ne paguajmë shpenzimet për shkollën e natës, 150 euro për semestër, nuk është shumë e madhe, por gjithsesi është tepër shumë e madhe për t'u përballuar nga një mbledhës mbeturinash...

Erëmirë Krasniqi: Paska vdekur shumë i ri, a është kjo jetëgjatësia...

Elizabeth Gowing: Po. Jetëgjatësia është shumë e shkurtër për... nuk mund t'i kujtoj figurat tani por mendoj se krahasuar me jetëgjatësinë mesatare të Kosovës, për romë, ashkali dhe egjiptas, jetëgjatësia mesatare është është shtatë vjet më pak. Mendoj se në rastin e tij, ishte diçka më specifike, një lloj sulmi në zemër por ishte, quhet atrial myxoma. Është një gjendje e caktuar e zemrës e cila jo domosdoshmërisht lidhet me mbledhjen e mbeturinave apo me të qenit i varfër, por natyrisht që gjithë këto gjëra janë të lidhura dhe kishte nivel të lartë të pirjes së duhanit dhe kualitet tepër i ulët i ajrit për arsye se këta njerëz jetonin në një dhomë tepër të vogël me stufë drush apo linjiti.

Natyrisht njerëzit bëjnë zgjedhje të gabuara sepse nuk kanë edukim dhe shpesh shpenzojnë para në diçka që nuk është shumë e rëndësishme për shëndetin e tyre. Njëri nga fëmijët kishte temperaturë dhe ata nguten për të shkuar në një spital privat kur në fakt vetëm do të mund t'i jipnin fëmijës lënje gjatë natës, ta linin të pushojë dhe në mëngjes do të ishte mirë. Por në anën tjetër fëmija mund të përjetojë sulm epileptik dhe ata nuk e konsiderojnë të rëndësishme të shkojnë tek doktori.

Pra ata nuk marrin vendime të duhura në lidhje me gjërat në të cilat duhet t'i fokusojnë paratë, apo nuk kanë vëmendjen e duhur për shëndetin e tyre. Dhe shpesh ka vetëm... nuk janë të vetëdijshëm për implikimet e gjërave që bëjnë. Sa i përket shëndetit nutritiv për shembull, ka shumë pak njohuri për rëndësinë e, e dini, nëse ke një buxhet të vogël... por a e shpenzon atë në fruta apo bizele apo a në akullore dhe gjëra të ëmbla për fëmijë apo... shpesh familjet duan t'i qerasin fëmijët e tyre, natyrisht të gjithë duan t'i kënaqin fëmijët e tyre. Kështu që, buxheti i tyre shpenzohet në gjëra të dëmshme për fëmijët e tyre në vend se të blejnë ushqim nutritiv.

Apo doktorët, siç e dijmë, sistemi shëndetësor në Kosovë është ndoshta kriza më e madhe e Kosovës dhe doktorët shpesh përshkruajnë gjëra që janë shumë të shtrenjta, mbase edhe krejt të panevojshëm, e kështu që ata përshkruajnë gjëra si Floradiksi, e dini, shurupi {shpjegon me gjeste} që ka vitamina në të. Një shishe Floradiks kushton njëmbëdhjetë euro, dhe të njëjtën gjë mund ta bësh duke blerë portokaj, spinaq dhe bizele. Kështu, njerëzit vijnë me recetën dhe përshkrimin dhe thonë, "Doktori më ka thënë se duhet të përdor këtë... dhe nuk mund të përballoj njëmbëdhjetë euro, a mund ta mbulonim ju?" Dhe kur e shikoj, ju them, "Jo, thjesht shko blej disa bizele. Bizelet do të kenë të njëjtin efekt për shëndetin tënd".

Por ata nuk kanë njohuri për të bërë gjykime të tilla sepse nuk janë edukuar rreth vitaminave apo rreth asaj se çfarë është Floradiksi. Nuk mund të lexojnë etiketën për të parë çfarë është, ata thjesht e dinë se doktori iu ka thënë të blejnë atë dhe se ajo do t'iu bëjë mirë. Tani jemi duke bërë edhe shumë punë shëndetësore, kemi edhe një këshilltar shëndetësor për komunitetin. Gjithashtu kemi një grua e cila vjen e punon me gratë rreth dyzet orë në javë, sepse po provojmë të sigurohemi që fëmijet të lindin në shtëpi. Aty ekziston një shkallë e lartë e mortalitetit të foshnjeve, jashtëzakonisht e lartë. Në Kosovë në njëmijë foshnje të lindura, dymbëdhjetë vdesin para datëlindjes së tyre të parë, kjo është shkallë tepër e lartë. Por në komunitetet roma dhe ashkalinj, kjo shkallë është 41 foshnje në njëmijë.

Kjo është skandal për të cilin po mundohemi të bëjmë diçka që të sigurohemi se fëmijet lindin në spital, që ata vaksinohen, që nënat dijnë si të kujdesen për foshnjat e tyre me gjëra si konsumimi i cigares dhe ushqimi me gji dhe si të kenë një...

Erëmirë Krasniqi: A keni gjetur ndonjë mënyrë për t'i mbështetur përmes The Ideas Partnership, çfarë është...

Elizabeth Gowing: Gruaja që vjen... ajo vjen dhe mban sesione, konsultime me gratë. Dhe asistenti ynë shëndetësor për komunitetin bën vizita nëpër shtëpi, në të gjitha shtëpitë ku ka foshnje, iu dërgon disa batanije, rroba dhe... gjithashtu kontrollon dokumentet për të parë çfarë kanë thënë në spital, si kanë shkuar kontrollat dhe a janë vaksinuar fëmijët. E dini, ia përkujton nënës se kur duhet të shkojë sepse kur nuk mund të lexosh, e ke parasysh, sapo ke lindur një fëmijë, sapo ke dalë nga spitali, nuk mund të kujtosh gjithë ato informacione.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë bëjnë fëmijët për të ndihmuar të tjerët?

Elizabeth Gowing: Kemi një Këshill të Fëmijëve që është grup fëmijësh, një fëmijë nga secila grupmoshë që vijnë nëpër klasët tona. Ata takohen çdo muaj, kanë një buxhet të vogël, 50 euro në muaj dhe ata duhet të vendosin si ta shpenzojnë atë buxhet për përfitim të njerëzve të tjerë, pra jo për përfitime të vetat. Dhe po, nuk përfundova fjalinë rreth bursave dhe pranuesve të bursave, i paguajmë për të shkuar në shkollë të natës ose në universitet, por në këmbim ata duhet të bëjnë diçka për komunitetin e tyre çdo javë. Kështu që shumica prej tyre bëjnë punë vullnetare në aktivitetet tona të së shtunës, ku fëmijët vijnë për mbështetje akademike.

Disa prej tyre ndihmojnë me shpërndarjen e rrobave, disa të tjerë me transport, ndonjë prej tyre ndihmon për të shkuar në vizitë tek gratë shtatzëna. Çkado që ata janë të interesuar, disa prej tyre kanë pasur një klub futbollit, po mendoj, ata mund të bëjnë gjëra që janë në interesin e tyre por po mundohemi të inkurajojmë sensin e angazhimit shoqëror dhe pjesëmarrjen në komunitet. Tani po shpërndahemi, po mendoj projekti ynë më i madh është Fushë Kosova, dhe ky projekt ka qenë i pari për ne, por tani jemi në gjashtë komuna. Punojmë në Lipjan dhe në qytezën e Janjevës, në Gjakovë ku punojmë me fëmijët e verbër, ky është një projekt i ndarë, se bashku me Shoqatën e të Verbërve atje. Punojmë në Istog dhe zyra jonë është në Prishtinë, pra jemi aktivë...

[Pjesa në vijim është realizuar më 23 shkurt, 2018]

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Dhe çfarë ndodhi tutje?

Elizabeth Gowing: E dërguam Gjejlanten në shkollë? Po, po. Kemi pasur një përvojë të mrekullueshme, kjo ishte njëra prej ditëve ku unë jam ndjerë më së shumti krenar, ishim duke ecur, unë isha në krye të një rreshti prej 62 fëmijëve duke ecur nëpër shkollë, jemi nisur nga qendra e mahallës në Fushë Kosovë. Dhe e dini, ndërsa ecnim, kishte kaq shumë njerëz nga komuniteti duke thënë, "Ku po shkoni

dhe punë e paçme!” Dhe e ke parasysh, dukej sikur një lloj ceremonie dhe goxha njëfarë arritje, fëmijët ishin shumë krenarë, ajo ditë ishte e mrekullueshme.

Ndihesha sikur kishim arritur atë që i kishim vënë vetes qëllim. Kisha thënë se do të na duheshin gjashtë muaj dhe kishin kaluar pothuajse saktësisht gjashtë muaj dhe përgjatë kësaj kohe, në një moment ishte gati për të mos u arritur. Por ia dolëm! Por pastaj njerëz të ndryshëm më thanë se nuk duhet të ndalonim aty sepse nëse do të ndalonim, me siguri gjithë ajo që kishim arritur thjesht do të humbte sepse shkollat dukshëm nuk i donin fëmijët, përndryshe do t’ua kishin lehtësuar punën për të shkuar që në fillim.

Të gjithë fëmijët ishin, po mendoj, disa prej tyre ishin dy vjet prapa, disa të tjerë pesë vjet prapa, pra të gjithë ishin duke hyrë në një sfidë... pra ata do të ishin 14 vjeç në klasë të parë, e keni parasysh. Kjo gjë nuk është e lehtë për mësuesit e as për ata, kështu që...

Erëmirë Krasniqi: Si është menaxhuar e gjithë kjo?

Elizabeth Gowing: E ke fjalën nga shkolla?

Erëmirë Krasniqi: Nga shkolla, dhe si keni asistuar ju?

Elizabeth Gowing: Epo shkolla, po mendoj, mësuesit natyrisht ishin tepër të palumtur që kishin këta fëmijë në klasët e tyre. Me gjasë ata ishin dukshëm fëmijë të ndryshëm, ishin të varfër dhe nuk kishin pasur asnjë mësim paraprak. E keni parasysh, ka mësues klasët e të cilëve janë plot dhe tashmë ata kishin nga 38 fëmijë nëpër klasët e tyre, tani po u kërkohej të shtonin edhe tre fëmijë të tjerë...

Por ishte e tmerrshme, të gjithë fëmijët ishin në korridorin e shkollës së bashku me të gjithë fëmijët e tjerë, duke filluar shkollën. Dhe drejtori i thirri mësuesit jashtë për t’i marrë fëmijët, dhe natyrisht, disa prej fëmijëve mbetën në fund, e keni parasysh ajo që duhej të ishte përvojë tepër pozitive, për fëmijët u shndërrua në një përvojë të tmerrshme.

Dhe javën e parë, njëmbëdhjetë fëmijë u dërguan në shtëpi për justifikime nga më të ndryshmet, “Je tepër i madh për karrige, je tepër i vogël ose kthehu kur të ndërtohet *objekti i ri* [flet shqip]” Dy fëmijë, vëlla dhe motër, i kishin thirrur para gjithë klasës dhe mësuesi kishte thënë se ata kanë zgjedhë ose pleshta, nuk më kujtohet cila dhe ne i dërguam tek doktori pastaj, ata nuk kishin pleshta por pastaj refuzuan të shkojnë në shkollë sepse ishin turpëruar. Pra, mësuesit tentonin mënyra të ndryshme vetëm për t’i larguar këta fëmijë të cilët...

Erëmirë Krasniqi: Për t’i dekurajuar për të marrë pjesë?

Elizabeth Gowing: Po, por mendoj se një nga gjërat që ne kemi bërë e që me shpresë iu ka ndihmuar mësuesve dhe sigurisht edhe fëmijëve ishte ideja e njerit prej vullnetarëve tanë, se duhet të fillojmë aktivitete të së shtunës në mënyrë që fëmijët të mund të bashkohen e të shohin njëri-tjetrin dhe të kenë një lloj solidariteti. Ata gjithashtu kishin mësim shtesë për arsye se ishin shumë prapa. Filluam këto aktivitete dhe ende vazhdojmë me to edhe shtatë vjet pas, dhe kemi rreth tetëdhjetë apo nëntëdhjetë fëmijë që ende vijnë çdo të shtunë. Pra, jo vetëm fëmijët e parë, por ka fëmijë që vijnë të

cilët kanë qenë gjithmonë në shkollë, janë regjistruar në mënyrë të rregullt, edhe ata vijnë thjesht sepse duan të jenë me shokët e tyre dhe kjo është diçka e mirë.

Dhe psataj kemi disa fëmijë që ende vijnë, që nuk janë në shkollë për ndonjë arsye dhe ky është edukimi i vetëm që marrin, duke ardhur të shtunave. Ka aktivitete tepër të mira që udhëhiqen nga vullnetarët, dhe pothuajse të gjithë vullnetarët janë nga komuniteti, duke përfshirë një grup të cilin e quajmë “mësuesit e vegjël”, të cilët janë adoleshentë nga komuniteti të cilët kanë marrë trajnime çdo javë, ata kanë trajnime për mendimin kritik dhe pak për pedagogji. Gjithashtu ata organizojnë një *shëtitje* [shqip] çdo javë, pra kanë disa përfitime. Por në këmbim, ata iu japin mësim fëmijëve të komunitetit çdo të shtune, gjë e cila mendoj se është një model i rëndësishëm, e ke parasysh.

Kjo është njëra prej mënyrave përmes të cilave organizata jonë është rritur prej atëherë, është maturuar, prej fillimit. Sepse në vitin 2011, ishte vetëm një zonjë e çmendur angleze, kryesisht vullnetarë të huaj dhe disi ishim në ajër, i ndihmonim fëmijët dhe ktheheshim në shtëpitë tona. Tani njerëzit nga komuniteti ndimojnë komunitetin, dhe kjo është shumë më e qëndrueshme dhe e shëndetshme.

Erëmirë Krasniqi: Përmendët *shëtitjet* [shqip] dhe po mendoja, a e kanë rastin fëmijët nga komuniteti të shohin pjesë tjera të Kosovës?

Elizabeth Gowing: Kjo është arsyeja pse kemi organizuar këto shëtitje sepse shumë prej fëmijëve, shumë prej fëmijëve nuk kanë qenë as në Prishtinë. Disa prej tyre e njohin Prishtinën shumë mirë sepse janë ata që mbledhin mbeturina, shkojnë nëpër kontejnerë, dhe ata në fakt e njohin Prishtinën më mirë sesa unë, i njohin të gjitha rrugicat.

Pra, ata kanë një hartë të ndryshme të Prishtinës nga ajo e imja. Por disa nga fëmijët nuk kanë qenë fare dhe edhe kur vijnë në Prishtinë ata nuk shkojnë në teatër apo në galeri të arteve apo kinema. I kemi dërguar në këto vende dhe nëpër Kosovë, e keni parasysh, në Prizren dhe jemi munduar të mendojmë për Novobërdën, e ke parasysh, vendet e trashëgimisë kulturore dhe Gërmia, e ke parasysh, edhe vende argëtimi.

Kemi edhe fëmijë që vijnë nga jashtë për të folur me fëmijët sepse ideja e zgjerimit të horizontit të tyre është me të vërtetë e rëndësishme. Kështu që mendoj se kjo është diçka që tregon se kemi lëvizur nga ajo pikë e fillimit. Por një gjë tjetër që ka qenë shumë e rëndësishme ndërkohë që fëmijët regjistroheshin në shkollë ishte se e kam kuptuar se pa qenë familjet e mbështetura ekonomikisht, atëherë në dimër, për fëmijët është koha më e vështirë dhe njerëzit sëmuren, iu nevojiten dru për zjarr, dhe kjo është periudha kur fëmijët më së shumti e lënë shkollën, prandaj na është dashur t'i ndihmojmë familjet financiarisht.

Prandaj kemi themeluar ndërmarrjen e grave për t'i punësuar nënat e fëmijëve që ishin regjistruar në shkollë, me kushtin që fëmijët të vazhdojnë të shkojnë në shkollë, ky ishte kushti në bazë të të cilit ato mund të punësoheshin në këtë projekt. Dhe pastaj përfitimet e shitjeve që ato bënin, shkonin direkt tek ato, ne nuk kishim asnjë përfitim, as për të mbuluar rrogën e koordinatorit tonë, kështu që patëm marrë një grant për të financuar rrogën.

Kemi filluar duke bërë sapunë dhe çanta *tote bags* [strajca]. Tani jemi zgjeruar, bëjmë kartolina me dizajn të filigranit pra bashkëpunojmë me një kooperativë në Prizren që bën filigran të argjendtë. Pastaj gratë qepin ngapak stoli në kartolinë kështu që është kartolinë por gjithashtu dhuratë. Sepse mund të përdorësh stolitë sikur kjo stoli {tregon stolitë e saj}. Dhe po, mendoj se produktet që bëjmë, jemi gati duke filluar të bëjmë qirinj, pra kemi një varg produktesh.

Kemi gra në Fushë Kosovë në këtë dhe gra nga Istogu, në fakt ajo pjesë e projektit sapo është mbyllur në fund të vitit të kaluar. Gjithashtu kemi gra nga Janjeva në projekt. Është projekti më i madh, më duket se kemi pasur më shumë se tridhjetë gra të përfshira në të, tashmë është paksa më i vogël. Por ka qenë një model shumë i rëndësishëm, kemi këtë model i cili nuk është ai me të cilin kemi filluar por tani e kemi konstruktuar rreth asaj që bëjmë, që do të thotë se ndihmojmë njerëzit në nevojë, ndihmojmë njerëzit në nevojë për të ndihmuar vetveten. Por gjithashtu ndihmojmë njerëzit në nevojë për të ndihmuar njerëzit tjerë në nevojë.

Projekti me prodhimin e sapunëve dhe çantave është njerëzit në nevojë që ndihmojnë vetveten dhe pastaj mësuesit e vegjël për të cilët fola më herët është realisht ndihma ndaj fëmijëve në nevojë për të ndihmuar të tjerët. Dhe kjo mendoj se është formula magjike, nëse arrin të bësh diçka të tillë. Dhe nuk mendoj se shumë OJQ mendojnë për fazën e tretë, pra mendoj se kjo është diçka për të cilën jemi goxha krenarë që kemi përfshirë diçka të tillë në punën tonë.

Erëmirë Krasniqi: Cila është lidhja juaj me anëtarët e komunitetit, tani që je më larg, cila është lidhja personale...

Elizabeth Gowing: Familja e Gjejlans është familja e parë që kam takuar dhe ende... nuk mundem të kujtoj nëse e kam treguar këtë gjë më parë... kemi vendosur t'u ndërtojmë një shtëpi, kam folur për shtëpinë apo jo, dhe a kam treguar se babai i tyre vdiq pak pasi u vendosën në shtëpinë e re. Pra, papritmas kjo familje u bë tepër fragile dhe shumë njerëz të cilët ishin prekur nga ky tregim, ky është tregimi që kam shkruajtur në librin tim, dhe shumë njerëz lexojnë librin e takojnë familjen në atë mënyrë, kështu që shumë njerëz kanë dashur të dhurojnë para për familjen në atë mënyrë.

Nuk kemi dashur t'iu japim paratë direkt familjes, edhe kur kanë qenë në gjendjen më të brishtë, kemi dashur t'i kushtëzojmë disi dhe ky është kushti që fëmijët të shkojnë në shkollë. Sepse kur babai i tyre vdiq, djali më i madh i familjes më tha, "Më duhet të marr karrocën e babait dhe të lë shkollën".

Dhe e keni parasysh, kjo nuk është ajo që babai yt dëshironte prandaj nuk do të lejojmë diçka të tillë të ndodhë. Por kjo ishte një betejë e vërtetë disa muaj pas vdekjes së babait të tyre, natyrisht fëmijët ishin shumë të trishtuar, nëna e tyre ishte tepër e trishtuar dhe goxha e brishtë, kështu që familja kishte me të vërtetë nevojë për mbështetje dhe ne thamë, "Puna juaj është të shkoni në shkollë dhe nëse shkoni në shkollë, ka shumë njerëz në Angli që do të ndihmojnë familjen tuaj". Kështu që kemi formuar një lloj sponsorizimi në mënyrë që të gjithë fëmijët të shkojnë në shkollë dhe nëna e tyre të marrë para çdo javë dhe fëmijët të marrin para xhepi, kështu që kjo mënyrë ishte disi motivuese.

Dhe kjo ishte betejë e vërtetë për gjashtë muaj, e dini, njëri nga fëmijët thjesht nuk shkoi në shkollë për katër muaj, thjesht u dorëzua, vazhdonte të ikte nga shkolla kur nëna e tij e dërgonte, ajo e linte në shkollë dhe largohej dhe pastaj ai ikte përgjatë pushimit. Por ata janë, me përjashtim të Gjejlans e

cila tani mban mbulesë dhe kështu nuk mund të shkojë në shkollë, të gjithë të tjerët janë në shkollë. Unë shkoj tek ata sa herë që jam në Kosovë, që i bie ndoshta dy herë në muaj, shkoj dhe i vizitoj. Kam një lidhje të afërt dhe kontaktoj me ta në Skype apo në telefon, ndoshta njëherë në disa ditë kur nuk jam në Kosovë.

Pra kjo është ajo që më mban të lidhur dhe mendoj se roli im ka ndryshuar paksa sepse kjo është diçka për të cilën mendoj shumë përgjatë pushimit tim, prandaj ndoshta tregimet e mia kanë ndryshuar (qeshë). Por mendoj se shoh një pjesë të madhe të rolit tim për të bashkuar Britaninë e Madhe me Kosovën. Ka shumë njerëz në Britani të Madhe që interesohen, ose që mund t'i bëjmë të interesohen nëse iu tregon një rrëfim të tillë, mund t'i bësh të interesohen. Disa prej tyre kanë lexuar librin tim, disa prej tyre kanë qenë vullnetarë me ne, disa prej nesh kemi ardhur në Kosovë me organizata të tjera por kemi dashur të ndihmojmë, dhe e shoh The Ideas Partnership si një mënyrë për të bërë diçka të tillë.

Kemi shumë njerëz që dëshirojnë të dhurojnë, ndoshta para, ose dëshirojnë të dhurojnë... po mendoj, valigjja e madhe që solla me vete sot, ajo është arsyeja pse u vonova, është plot me këpucë që janë dhënë donacion nga njerëzit në Angli. Sepse ata thonë, e ke parasysh, "Këto këpucë janë të vogla për fëmijët e mi, dua t'i dhuroj për një fëmijë që do t'i veshë për të shkuar në shkollë". Dhe mendoj se kjo është diçka që The Ideas Partnership e bën shumë mirë, fakti që e krijojmë lidhjen direkte në mënyrë që gruaja që dhuron këpucët e fëmijëve të saj, pranon një fotografi të djalit që është duke i veshur tani ato këpucë në Fushë Kosovë, ne i dërgojmë ato dhe themi se ky është *filan* [shqip], ai është në shkollë dhe nëna e tij dëshiron të të falenderojë, dhe e keni parasysh, në mënyrë që ato të ndihen të lidhura.

Pastaj i dërgojmë ato tek *filani* [shqip], i themi se këto vijnë nga një zonjë në Angli dhe këto i ka veshur i biri i saj, tani ajo dëshiron që ti t'i mbash ato. Dhe kështu mendoj se e bashkojmë botën, po...

Erëmirë Krasniqi: Lidhje personale...

Elizabeth Gowing: Saktësisht. Cila ishte pyetja juaj, isha duke...

Erëmirë Krasniqi: Ishte më shumë rreth asaj se cila është lidhja juaj tani?

Elizabeth Gowing: Mendoj se tani një prej gjërave të rëndësishme që mund të bëj është të jem ajo që krijon lidhje kështu që gjithmonë kur jam në Angli, që i bie një herë në muaj, gjithmonë kthehem me një valixhe të madhe. Shpesh dy, sepse British Airways më lejon dy valixhe. Dhe sjell rroba fëmijësh, veçanërisht rroba fëmijësh dhe batanije e këpucë fëmijësh e gjithçka tjetër. Dhe pastaj të shtunën shkoj nëpër familje në Fushë Kosovë dhe ua dhuroj ato foshnjeve të posalindura, të vejave, familjeve të cilat janë duke kaluar nëpër kohë të vështira, dhe bëj një fotografi të cilën e dërgoj me një përshkrim të shkurtër.

Pra, kjo është një pjesë për të cilën mund të kontribuoj, tani kemi staf, kemi një staf lokal. Kemi 27 pjesëtarë të stafit, jo të gjithë punojnë me orar të plotë, po mendoj shumica prej tyre punojnë me gjysëm orare. Por gjithsesi, 27 pjesëtarë të stafit, dhe gjysma prej tyre janë nga komunitetet roma, ashkalinj dhe egjiptas...

Erëmirë Krasniqi: A e angazhoni të tërë komunitetin përmes kësaj pune?

Elizabeth Gowing: Në Fushë Kosovë, po mendoj, në një mënyrë apo në një tjetër kemi prekur të gjitha familjet, e keni parasysh. Kemi një kopësht me tetëdhjetë njerëz dhe ajo ka tri vjet ekzistencë tani, nëse mendoni, sa gjenerata fëmijësh i bie...

I kemi dërguar gjithë këta fëmijë në shkollë çdo vit, e keni parasysh, jo vetëm në vitin 2011. Dhurojmë rroba, ofrojmë bursa për të rriturit që dëshirojnë të kthehen në skollë të mesme, iu ofrojmë shkollën e natës në mënyrë që të marrin certifikatën. Pra ka shumë mënyra përmes të cilave kemi prekur njerëz të ndryshëm, dhe një program të madh për gratë shtatzëna, për shtatzëni të sigurtë. Kemi rreth dyzet gra në Fushë Kosovë dhe rreth dyzet gra në Janjevë të cilat çdo javë marrin vitamina dhe ne paguajmë transportin për t'i dërguar në spital në mënyrë që të lindin në kushte të sigurta.

Dhe marrim batanijet të cilat janë thurur nga gratë në Angli, e keni parasysh, pra do të thoja se jam shumë e afërt me komunitetin, e ke parasysh, për t'iu përgjigjur pyetjes tënde. Nuk jemi vetëm në atë komunitet, jemi në Fushë Kosovë, Janjevë, Lipjan, Obiliq, Gjakovë, Graçanicë, ishim në Istog deri në fund të vitit të kalur. Dhe ndihem se është edhe një vend tjetër, ndoshta, po, Prishtina meqë kemi zyrën këtu dhe ndoshta po mendoj për këtë, pra...

Erëmirë Krasniqi: Si jeni zgjeruar, po mendoj... sepse keni filluar në Fushë Kosovë.

Elizabeth Gowing: Po, dhe Fushë Kosova është ende projekti ynë më i madh, e keni parasysh, në Fushë Kosovë kemi gjithçka. Ndërkohë që në vende të tjera kemi kopështin por vetëm tri herë në javë, në Fushë Kosovë është çdo ditë. Në Janjevë kemi ndërmarrjen shoqërore poashtu dhe kemi disa klasë por jo aq shumë, jo si aktivitetet tona të së shtunës. Kemi klasën e artit, kemi orët e anglishtes, kemi orët e shqipes në ditë të caktuara të javës.

Në Obiliq kemi klasë për fëmijë më të rritur tri herë në javë. Nuk kemi ndërmarrje sociale e asnjë punë shëndetësore në Obiliq. Në Gjakovë punojmë specifikisht me fëmijë të verbër dhe jo vetëm nga komuniteti por nga të gjitha komunitetet, punojmë së bashku me Shoqatën e të Verbërve, pra ky është një projekt krejtësisht i ndryshëm. Nuk ka punë antenatale, as ndërmarrje shoqërore. Thjesht punojmë për t'i mbështetur këta fëmijë në shkollë.

Pra mendoj se idealisht... do të thoja se kemi një organizatë që ka një numër tepër të madh të vullnetarëve, kemi rreth njëqind vullnetarë, 120 vullnetarë. Kemi një qendër, disa qendra, një qendër në Janjevë, një në Fushë Kosovë, disa të tjera në vende të tjera. Dhe nëse dikush na tregon për ndonjë nevojë që ka, ne mund të mobilizohemi dhe t'i realizojmë nevojat, ta zgjidhim problemin. E dini, një ditë dikush më tha, dikush nga komuniteti në Fushë Kosovë më tha, "Me të vërtetë kemi nevojë për orë të gjermanishtes".

Ka shumë njerëz që janë kthyer nga Gjermania ose fëmijë që janë rritur në Gjermani ose fëmijë që duan të zhvendosen në Gjermani apo të fejoen me dikë të atij komuniteti të njerëzve që jetojnë në Gjermani, dhe unë dërgoj një email të gjithë vullnetarëve dhe kishim një në qendrën tonë brenda më pak se një jave, ishim të aftë të fillojmë me orë të gjermanishtes. Dhe e ke parasysh, mendoj se asnjë OJQ tjetër mund të funksionojë ashtu sepse normalisht duhet të aplikosh për fonde dhe do të

duheshin deri në gjashtë muaj për të marrë një aprovim dhe deri atëherë nuk do të kishte pasur interesim. Prandaj, pikërisht për këtë arsye, ne kemi mundësi të jemi shumë të shpejtë në gjetjen e zgjidhjeve.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull. Po mendoja, në fakt nëse nuk ke asgjë për të shtuar për The Ideas Partnership, po mendoja për librin, a gjen inspirim nga puna që bën atje? A janë këto non-fiksione kreative apo fiksjon i pastër, a mund, a mund të na tregosh?

Elizabeth Gowing: Pra, quhet “*Travels in Blood and Honey. Becoming a Beekeeper in Kosovo*” [Udhëtime në Gjak dhe Mjaltë. Të Bëhesh Bletar në Kosovë]. Pra ky njëmend tregon rrëfimin e asaj kur kam arritur në Kosovë për herë të parë në vitin 2006 deri në vitin 2008 kur jemi larguar nga Kosova, kapitulli i fundit flet për kohën kur jemi larguar nga Kosova. Kur kemi menduar se, e keni parasysh, kur Rob gjeti një punë në Angli dhe kemi menduar se kohës tonë në Kosovë po i vinte fundi. Pak dinim se (qeshë) ai ishte vetëm fillimi. Por... kjo është, kjo është ndjenjë komplet tjetër për mendimin tim sepse flet për atë se si është të bëhesh bletar por gjithashtu flet për mësimin jo vetëm bletarinë. Por mësimin e historisë së Kosovës, traditave dhe ushqimit të saj. E keni parasysh, në libër ka receta për gjërat që mund të bësh me mjaltë.

Është një libër shumë i ëmbël dhe lirik. Mendoj se disi flet shumë për peisazhin, periferitë, fshatrat dhe disi është një tregim dashurie për mua, e dini, rënie në dashuri me Kosovën. Dhe, po, e dini, e dua atë libër sepse me të vërtetë flet për atë, udhëtimin. Por, më kujtohet se kishte një recension që thoshte se ishte shumë jokritik ndaj Kosovës dhe mendoj se kjo është e vërtetë, po mendoj, nuk kam dashur të jem kritike por gjithashtu nuk kisha hyrë shumë thellë, nuk kisha takuar ende komunitetin në Fushë Kosovë në mënyrë që të shihja disa nga problemet dhe frustrimet. Kështu që, po, është një tregim dashurie, kur dashurohesh në dikë, nuk je kritike (qeshë).

Pastaj libri i dytë që kam shkruajtur, në fakt kam filluar ta shkruaj para se të botohej i pari, ky libër flet për Edith Durham, grua britanike e cila ka ardhur në Kosovë para njëqind vjetëve, ky është libër ndryshe, e keni parasysh, pjesërisht biografi. Quhet “Edith dhe Unë: Në rrugën e një udhëtareje edukative në Kosovë”. Pra, është pjesërisht tregimi i Edithit dhe pjesërisht tregimi im duke mësuar për të dhe duke ecur në hapat e saj. Pra, fillon me pjesën ku unë mësoj për të kur kemi jetuar këtu, por pastaj flet për mua që kthehem në Angli dhe mbetem në një banesë të vogël në Londër, duke u ndier e frustruar për faktin se jeta ime në Kosovë, e cila kishte qenë shumë e pasur dhe e lumtur, ishte, në fakt unë isha larguar nga ajo. Dhe unë teksa kujtoj se ka qenë një grua tjetër britanike e cila kishte shkuar në Kosovë njëqind vjet më parë dhe kishte pasur përvojë të mrekullueshme dhe pastaj i ishte dashur të kthehet në Londër në një banesë të tillë dhe kishte qenë shumë e frustruar.

Dhe po, kjo është arsyeja pse pata filluar të hulumtoj për të, pak nga malli për shtëpinë, po, kur isha në Angli mendoja për Kosovën, por në mes të procesit të shkrimit të librit, Rob fitoi një punë tjetër këtu kështu që pjesa e dytë e librit flet për udhëtimet e mia në Kosovë ku i kam përdorur udhëtimet e Edithit si udhërrëfime, pra është pjesërisht një libër udhëtimi, pjesërisht biografi e pjesërisht autobiografi. Dhe pastaj libri i tretë është tregimi i bashkëshortes së mbledhësit të mbeturinave, dhe kjo është shoqëri tepër e jashtëzakonshme në Kosovë që e tregon rrëfimin e Hetemes dhe Gjejlans si dhe takimin me atë familje dhe atë në të cilën ky takim më ka futur. Pra, ky me gjasë është libri që ka

më së shumti prani të vetes time në të, e keni parasysh, ky është tregimi që më intereson më së shumti sepse me të vërtetë i ka dhënë formë, të paktën për tani, asaj që unë jam.

Por ky libër është më shumë kritik ndaj Kosovës, nuk është një tregim dashurie sepse e ke parasysh, natyrisht që flet për frustrimet këtu dhe mënyrat se si disa komunitete diskriminohen këtu dhe.... Por me shpresë është një tregim pozitiv sepse ka një fund të lumtur dhe pastaj libri im më i fundit i cili është botuar vitin e kaluar është *The Silver Thread* [Peri i Argjendtë], i cili flet për filigranin e argjendtë, dhe nëntitulli *A Journey Through Balkan Craftsmanship* [Një udhëtim nëpër zanatet e Ballkanit]. Pra është një libër për Ballkanin, jo vetëm për Kosovën, edhe pse është i fokusuar kryesisht në Kosovë. Por ka disa kapituj për Shqipërinë dhe një tjetër për Stambollin. Dhe ky libër flet për filigranin e argjendtë dhe fillon, në fakt fillon shumë më përpara se libri im i parë.

Kontakti i parë që kam pasur me Kosovën është kur ishim duke jetuar në Londër dhe Rob pati fituar një punë në OSBE, një punë dy javëshe si monitorues i procesit elektoral përgjatë zgjedhjeve të para këtu. Pra në vitin 2001, ai erdhi këtu për dy javë dhe ishte i bazuar në Prizren dhe ishte, e keni parasysh, në një qendër votimi këtu dhe ai më solli filigran të argjendtë, një qafore tepër të thjeshtë. Dhe tregimi fillon me atë dhe pastaj shpjegon se si më është dhënë kjo qafore e bukur, e jashtëzakonshme dhe se si kam dashur të zbuloj se nga vjen ajo. Kështu që u ktheva në Kosovë, kam shkuar në minierë, në minierë në Trepçë për të parë prej ku vjen argjendi dhe pastaj kam shkuar në Novobërdë për të parë ku bëhet shkrirja. Pastaj kam shkuar në Prizren për të parë se si ata në kooperativë punonin me filigran, dhe pastaj kam vizituar gratë, në fakt në Shqipëri, të cilat mbledhin filigran e të cilat disi më kanë treguar rrëfimet e, historinë e tij dhe pastaj kam shkuar...

Erëmirë Krasniqi: Cilat janë tregimet rreth këtij lloji zanati?

Elizabeth Gowing: Po, sidomos mënyra se si përdoret, ka disa detaje, detaje teknika në libër rreth asaj se si bëhet filigrani, këto lloje teknika. Por ajo që më intereson më shumë është konteksti njerëzor, të kuptuarit e asaj se si për shembull, pa marrë parasysh sa e pasur ka qenë një grua, edhe nëse ka pasur mundësi të ketë gjithë stolitë e arit, ajo gjithmonë është dashur të ketë një stoli të argjendit sepse argjendi kishte fuqinë të largojë syrin e keq. E keni parasysh, pra, argjendi është i rëndësishëm, nuk është vetëm ari i të varfërve, është i rëndësishëm në vetvete. Dhe pastaj *xhubleta* [Shqip], kostumi tradicional shqiptar, kam shkuar në Malësi të madhe dhe në Lugun e Bjeshkëve, ku të gjitha gratë e reja, nuset e reja nga të gjitha fushat vishen me *xhubletë* e cila është e vjetër ndoshta deri në tremijë vjet ose diçka ashtu, si stil.

Dhe kanë gjithë ato stoli të ndërlikuara dhe ka disa lloje të veshjeve tradicionale, gratë kishin tong të zgjatur si zinxhir i gjatë me tong dhe pastaj ajo ishte ashtu në mënyrë që gruaja të mund të merrte prush, gacë të djegur nga *mangalli* [shqip] në mënyrë që t'ia ndizte cigaren burrit të saj me të, kështu pra ajo duhej të kishte tong. Dhe pastaj thonë se ajo duhej të mbante dorën kështu {shpjegon me duar}, sepse Zoti mos e bëftë që gaca që digjej të binte në këmbët e burrit, ajo duhej të binte në dorën e saj fillimisht.

Pra po, kam mësuar, këto gjëra të mësojnë edhe për shumë gjëra tjera dhe pastaj simbolizmi i shumë bletave, në fakt, të bëra nga filigrani sepse kjo simbolizon punën e madhe dhe ëmbëlsinë që nusja sjell në familje. Plot trekëndësha sepse ata janë kundër syrit të keq, dhe e keni parasysh, kjo është mënyrë

e të kuptuarit të njerëzve, dhe pastaj kur shkon e sheh të gjithë filigranistët e rinjë në Prishtinë të cilët kanë, edhe vetëm disa gra të reja që sapo kanë filluar biznesin. Është e mrekullueshme të futesh në dyqanet e tyre dhe të shohësh gra të reja, profesionale teksa blejnë filigran aty. Dhe kjo është një shije e Renesancës në Koovë, njerëzit nuk blejnë Swarovski në fund të rrugës, ata blejnë në këto dyqane. Dhe e blejnë si dhuratë për ndonjë kolege biznesi apo diçka e tillë. Gratë moderne blejnë filigran, pra ky është tregimi që e rrëfej. Ajo që ka qenë shumë interesante me këto libra është që kam biseduar shumë rreth librave të mi sepse më pëlqen të bëj...

Erëmirë Krasniqi: Cila është audienca? Kjo më intereson.

Elizabeth Gowing: Po, kjo gjë ka qenë interesante. Kur kam filluar... fillimisht ka qenë libri për bletët ku kam rënë në kontakt me të gjitha organizatat bletare në Angli dhe disa prej tyre.... Ata janë kryesisht bujqë të interesuar në bletari dhe praktikën e saj, por disa grupe kanë qenë të interesuara të dëgjojnë rreth bletarisë në një vend tjetër dhe pastaj kam filluar... duke folur me disa grupe grash, ekziston një rrjet i madh i quajtur Instituti i Grave i cili ka... rreth tridhjetë mijë, jo s'mund të ketë kaq shumë, ndoshta tre mijë grupe në Britani, degë në Britani. Por sidoqoftë, e keni parasysh, janë shumë. Dhe ato janë kryesisht gra të moshuara, kryesisht në zona rurale. Shpesh shumë tradicionale, ky institut ka një reputacion në Britani për atë se është rreth përgatitjes së gjemtit në shtëpi dhe artizanateve, edhe pse jo të gjitha grupet janë të tilla. Por pra, kjo ka qenë një audiencë mjaft e moshuar që nuk kanë ditur për Kosovën dhe kanë qenë të interesuar, e keni parasysh, të mësojnë diçka.

Dhe pastaj, sidomos me librin e fundit, është një grup në Britani i quajtur Shoqëria e Artit që ka rreth gjashtëqind degë nëpër Britani dhe secila prej tyre ka një ligjëratë çdo muaj për një temë rreth artit, arteve të bukura. Ata gjithmonë kërkojnë ligjerues dhe janë goxha rigoroz në përzgjedhjen e ligjeruesve, kështu që më është dashur të kaloj nëpër këtë proces por tani jam në listën e tyre dhe kryesisht bisedat kryesore që bëj janë për shoqëritë e artit të cilat janë grupe të mëdha, zakonisht mbi njëqind. Kam pasur një të hënën, kishte rreth 150 njerëz në mëngjes dhe 130 pasdite, kështu që supozoj se kjo është paksa më ndryshe, duhet të paguash goxha më shumë për t'u bërë pjesë e atij grupi, krahasuar me të tjerët për të cilët po flisja.

Këta janë njerëzit, që e keni parasysh, e konsiderojnë veten të kulturuar dhe edukuar dhe janë të interesuar në arte të bukura. Është e mrekullueshme të kesh mundësi të flasësh me gjithë këta njerëz të ndryshëm. Tani kam bërë rreth 160 fjalime (buzëqeshë), dhe nëse e llogaritë, dalin më shumë se njëmijë njerëz me të cilët kam folur, kështu që kjo më bën tepër krenare, pra mund të shkoj dhe të tregoj tregimin e Kosovës dhe tregimin tim.

Erëmirë Krasniqi: Cilat janë pyetjet, po mendoj, çfarë lloj kurioziteti ngjall libri?

Elizabeth Gowing: Pyetjet e mia të preferuara janë kur njerëzit pyesin për turizmin këtu. Dhe e keni parasysh, disi mendoj, "Oh, shpresoj që kjo do të thotë se ata do t'vijnë". Dhe njëherë kam marrë një email teksa isha ulur në Prishtinë që thoshte, "E dashur Elizabeth, po të dërgoj këtë email nga Hoteli Grand. Nuk do të isha kurrë këtu nëse nuk do të kishe ardhur në Institutin e Gruas në Wimbledon vitin e kaluar (qeshë)". Dhe kjo më bën tepër krenare.

Dhe pastaj njerëzit shpesh duan të dijnë, në fakt janë tepër të interesuar për luftën dhe politikën. Ndoshta kjo është e vetmja gjë që njerëzit dijnë për Kosovën, ose të paktën mendojnë se dijnë për Kosovën. Shpesh duan të pyesin edhe për kualitetin e jetës, e ke parasysh, kujdesin shëndetësor, punësimin, energjinë elektrike, e ke parasysh, gjëra të tilla. Dhe kur flas për filigranin njerëzit gjithmonë dëshorjnë të blejnë dhe bëjnë pyetje, “Ku mund ta blej?” Sepse natyrisht e kanë zbuluar sa shumë vlerë ka dhe e kuptojnë punën që bëhet për të arritur aty, është e mrekullueshme të kem kartolinat të cilat i kanë bërë gratë në projektin tonë sepse në këtë mënyrë njerëzit mund të blejnë një pjesë të filigranit kosovar.

Kemi edhe një bashkëpunim me një dizajnere në Cornwall, e cila në fakt ka bërë këta vathë {prekë vathin e saj}, pra filigrani në këta vathë është i bërë nga një filigranist këtu, pastaj ajo i kombinon ato me kristale, rruza e perla apo çfarëdo, për qafore e vathë dhe... ato shiten mjaft mirë, dhe ajo dhuron fitimin, ajo dhuron gjithë fitimin për The Ideas Partnership. Pra, të gjithë fitojnë.

Erëmirë Krasniqi: Mendoj se mund ta mbyllim këtu por po mendoja nëse keni diçka tjetër për të shtuar? A mendoni se mund të na tregoni diçka tjetër...

Elizabeth Gowing: Po mendoj, gjithmonë ka diçka më shumë (qeshë) por jo, mendoj se mjafton.

Erëmirë Krasniqi: Në rregull, falemnderit! Falemnderit shumë!